

ENTELE TABAKU

KATËR LEXIME
PËR NJË POEZI

Doracak

BOTIME



BOTIME



Autore: Entela Tabaku
Copyright: Entela Tabaku, 2020

Kryeredaktore: Aida BARO
Redaktor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Elidor KRUJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9928-310-30-9

*Botuar me mbështetjen e Uppsala Universitet,
Institutionen för Moderna språk.*

© Botime Pegi, shtator 2020

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ (0)42 374 947; cel: +355/(0)69 40 075 02;

e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al


Spektori i shpërndarjes: cel: +355/(0)69 60 778 14;

e-mail: marketing@botimepegi.al

Shtypshkronja Pegi: cel: +355/(0)69 40 075 01;

e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtja



Ftillim	7
Leximi i poezisë “Abuk Ajou“ të Gentjana Mingës.....	13
Leximi i poezisë ”Fëmija” të Eduart Ymerit	21
Leximi i poezisë “Fustani” të Ardita Jatrut	27
Leximi i poezisë “Hapa drejt dritës në fundin e këtij tuneli” të Sueton Zhugrit	33
Leximi i poezisë “Hapat e rëndë në korridor” të Lindita Ahmetit.....	39
Leximi i poezisë “Hera-herës” të Mariklena Niços	49
Leximi i poezisë “Homo Migrantis” të Shqiptar Osekut	53
Leximi i poezisë “Identitet” të Ilire Zajmit.....	59
Leximi i poezisë “Ke thithur ndonjëherë një dorëzonjë?” të Rudina Çupit	67
Leximi i poezisë “Korba unë!” të Eli Krasniqit	75
Leximi i poezisë ”Kosovës” të Daim Miftarit	83
Leximi i poezisë “mjeseve mundesh me ba sende me dritën” të Ledia Dushit.....	89
Leximi i poezisë “Porsi një fëmijë” të Romeo Çollakut	95
Leximi i poezisë “sot është një nga ato ditët” të Enkeleda Ristanit..	103
Leximi i poezisë “Tokës” të Shqiponja Axhamit.....	109
Leximi i poezisë “Vegim” të Ndue Ukajt.....	115
Leximi i poezisë “Vjeshta e hershme dergjet në mua” të Arben Idrizit.....	121

Ftillim

Leximi i poezisë

Leximi është një akt zbulimi dhe gjurmimi të domethënies së shenjave. Në shumicën e rasteve, ky akt konsumohet që në leximin e parë: vjelja e domethënies përfundon aty ku përfundojnë shenjat. Kështu lexohen/vilen, për shembull, këta rreshta. Por poezia është ndryshe, meqenëse lind ndryshe. Në ndryshim nga shenjat e këtij teksti, shenjat që përçojnë poezinë janë të ngërthyer në inde figurative, për të cilat shpesh nuk është i vetëdijshëm as vetë poeti. Poezia është një art i hollë dhe enigmatik, që shkon përtej dëshirës dhe synimit të krijuesit: është arti i distilimit të pavetëdijshëm të ndjenjës dhe të mendimit. Prandaj poeti di çfarë ka dashur të shprehë, por jo çfarë shpreh; e di sfondin e poezisë së vet, çfarë ia dha shkëndijën, cila melodi, fotografi, ngjarje, mendim, aromë ia shtypi butonin e krijimit, por distilimi ndodh pavarësisht/jashtë vetëdijes së tij. Është talenti krijues që i zien, i kullon, i filtron, i avullon dhe i përçon shenjat e poezisë. Prandaj poezia është ndryshe edhe nga artet e tjera të shkrimit, që mbruhën në/me vetëdijen e krijuesit. Ajo ngjan më shumë me muzikën dhe pikturën, aty ku mbulohet dhe zbulohet në misterin e komunikimit me lexuesin. Këtu qëndron edhe kënaqësia e leximit të poezisë. Leximi i saj është një takim dashurie dhe përjetohet pashmangshëm në disa nivele. Duke

qenë i tillë, ka nevojë të përsëritet për t'u njohur e për t'u shijuar më mirë. Ky lloj leximi është si filli i Arianës që të çon te poezia e mirë, sepse vetëm poezia e mirë të zgjon dëshirën dhe nevojën për ta riletuar. Vetëm poezia e mirë shtresëzohet në vete dhe në lexuesin, në një mënyrë që ta lejojë e ta ftojë këtë të fundit të gërmojë më tej. Ky doracak është ftesë për një lexim të poezisë, i cili nuk ndalet në leximin e parë, në përshtypjet dhe përjetimet e menjëhershme, por rikthehet dhe kërkon përshtypjet që e presin lexuesin pak më thellë poezisë dhe vetvetes.

Katër lexime për një poezi

Dihet se leximi i parë është leximi i së dukshmes, i sipërfaqes. Sipërfaqja shpërfaqet zakonisht në dy dukje: Nga njëra anë të shfaqet tema, për çfarë flet kjo poezi. Nga ana tjetër të shfaqet gjuha poetike. Çfarë e mban këtë poezi në këmbë figurativisht, cilat janë metaforat, gjetjet, ritmi? Ndodh që leximi i parë të ketë të bëjë jo aq me sipërfaqen e poezisë, por me sipërfaqen e analogjive që të ngjall ky lexim. Lexuesi nuk mund ta dijë paradhënie se nga cili kah do ta shpie leximi i parë. Në lexim të parë vëren edhe si e bën të ndihet kjo poezi. A i hyn në gjak, a i flet apo ia kundron botën me sytë e tjetërkujt? Ky është edhe leximi që na mësojnë në shkollë tradicionalisht. Por nëse ky lexim i thotë të gjitha, i jep të gjitha, atëherë e di se kjo poezi ishte e këndshme dhe kaq. Ajo poezi që thotë e jep gjithçka në lexim të parë, është si pllakë varri: e lexon dhe kalon. Poezia e mirë të rikthen te vetja gjithmonë. Asaj nuk mund t'i ikësh, ashtu si nuk mund t'i iket vetes. Leximi i dytë nis e t'i zbulon sekretet e realizimit, është leximi i teknikës. Shumica e poezive nuk kanë sekrete, kanë vetëm metafora. Por talenti i vërtetë nuk qëndron në metaforat. Mendja e njeriut është një prehër i pafund metaforash. Talent i vërtetë qëndron në krijimin, shpesh spontan, të një ndërthurje

metaforash, gjendjesh dhe emocionesh që e rishpikin poezinë në mendjen e lexuesit. Lexuesi e gjen veten duke zbërthyer teknikën e poezisë, njëkohësisht që zbërthen veten. Në këtë pikë, poezia duhet lexuar me zë të lartë. Poezia e mirë e shtyn lexuesin në leximin e tretë: leximi i mendimit. Sepse poezia nuk është vetëm teknikë dhe fjalë. Është edhe mendim. Poetët e talentuar mbjellin mendime dhe përjetime në ne. Gjatë leximit të tretë zhvillohet një fill mendimi që mund të marrë kahe të ndryshme. Nganjëherë të shtyn të mendosh më tej fillin filozofik të autorit, nganjëherë të shtyn të përgjithësosh. Ky është sidoqoftë një lexim përsiatës që për disa poezi është më i rëndësishëm se vetë leximi i sipërfaqes, për disa të tjera jo. Në leximin e katërt, lexuesi e njeh mirë poezinë, tashmë. Nëse ka mbërritur deri këtu, e do këtë poezi, e dashuron. Për temën, gjuhën poetike, për mjeshtërinë e realizimit, për fillin e mendimit, por sidomos sepse në leximin e katërt ka për ta ndier poezinë deri në fund, ka për t'ia ndier dehjen, magjinë, do të jetë a thua se e ka shkruar vetë. Leximi i katërt është magjik dhe shumë personal, është leximi i vetes.

Kritere

Këtu lexohen shtatëmbëdhjetë poezi, të rreshtuara alfabetikisht dhe të përzgjedhura simbas dy kritereve: krijuesit e tyre janë të lindur midis viteve 1970-1979, që është edhe dhjetëvjeçari i lindjes sime, dhe janë të shkruara nga autorët në moshë të rritur, kur stili i autorëve është konsoliduar dhe stabilizuar. Këto dy veçori më duket se krijojnë një platformë të barabartë për të gjithë autorët. Krijojnë sigurisht edhe kontekste leximi. Një poezi mund të lexohet me pikënisje jetëshkrimin e autorit, të kohës në të cilën është shkruar apo ndikimet estetike të autorëve të tjerë, për shembull. Por ky doracak ka një pikënisje tjetër. Në të ofrohen instrumente për një lexim që e ka pikënisjen te teksti,

jo te konteksti. Një lexim që nënvizon lidhjen ekskluzive midis lexuesit e tekstit duke përjashtuar kontekstet e tjera. Poezia vetë i ka të përmbledhur të gjithë faktorët që e kanë ndikuar dhe krijuar dhe të nisesh nga konteksti për të mbërritur te teksti më duket një zgjatje e panevojshme (dhe shumë e mërzitshme) e rrugës. Është si të dëgjosh për dashurinë nga shkuesi, të ndjekësh fjalët dhe udhëzimet e tij dhe jo njohjen direkte. Nganjëherë, teksti vetë të çon te konteksti, por atëherë vjen si zhvillim i natyrshëm i leximit, i parë si takim midis lexuesit dhe tekstit. Ky takim është ngjarja më e veçantë mbas vetë krijimit të tekstit. Leximi i poezisë shihet këtu si çlirim i të gjitha konteksteve (të tekstit dhe të leximit) në një pikë të vetme: leximin. Në këtë mënyrë, lexuesi dhe teksti vijnë si dy protagonistë me të drejta të barasvlershme.

Filli i Arianës

Pakti i leximit është një pakt i heshtur midis poezisë dhe lexuesit. Poezia e di se po shkruhet për t'u lexuar. Edhe poeti më i rezervuar dhe refuzues, në momentin që i jepet shkrimi, e ka pranuar atë pakt. Përndryshe do ta mbante në mendjen e vet. Poezia që shkruhet shkon pashmangshmërisht drejt leximit, si shprehja e dashurisë shkon drejt puthjes. Poetët nganjëherë e mohojnë këtë lidhje, sepse u duket se i heq poezisë pak nga hiri hyjnor që u pëlqen t'i hedhin përsipër. Edhe lexuesi, nga ana tjetër, ka idetë e veta përmbi poezinë. Ky i fundit sidomos ka një ide të qartë se çfarë është dhe çfarë nuk është poezi, të krijuar nga ajo traditë e leximit që mëson se jo gjithçka mund të bëhet poezi. Një traditë e gjatë e leximit në sipërfaqe, e përforcuar nga kuti estetik i realizmit socialist që e shihte kritikën e poezisë si mihje në dhé, na ka shndërruar në lexues me parmendë. A thua se leximi i poezisë ka të bëjë me atë çfarë autori ka fshehur mbas plisave. Ose vetëm me këtë. Plisat e dheut hapen vetëm në

lexim të parë ndoshta, sepse mandej poezia e mirë të çon pezull në abstragim, nga dheu i autorit në dheun tënd. Kritika e poezisë do të duhej t'i përngjante kritikës së muzikës dhe të artit: të na ndihmojë ta lexojmë poezinë, të na tregojë se si mund të lexohet, çfarë alternativash ka, të na e mësojë veshin me poezinë e mirë derisa të arrijmë ta njohim e ta shijojmë. Poezia është shumë më tepër se fjalë me domethënie, nën a mbi domethënie, është përjetimi që krijon në lexuesin. Poezia lind (a rilind) kur takon lexuesin. Pa lexuesin, s'është veçse një masturbim i poetit. Dhe sa kohë kritika ta analizojë si të ishte ekzaminim anatomik i poetit a përçuese vlerash të një epoke, e të tjera të këtij lloji, do ketë vetëm lexues që lexojnë poezi sikur po dalin në arë për të punuar tokën.

A është kritiku atëherë një Arianë që të jep një fill të kuq për ta ndjekur dhe për t'u orientuar? Unë nuk kam përgjigje përfundimtare, kam vetëm një fill leximi që po ta zgjas ty.

Leximi i poezisë “Abuk Ajou” të Gentjana Mingës

Poezinë “Abuk Ajou” e ndesh në numrin 47 të revistës *POETEKË*. Është poezia e parë e një cikli nga Gentjana Minga. Sapo kam mbaruar së lexuari prozën e Ardian Kyçyikut, që më intrigon gjithmonë. Dua ta ndal leximin mbas tij, sepse emri i poetes më duket i njohur dhe më kujton disa poezi të saj të ftohta të lexuara në fillim të viteve 2000. Por, *POETEKËS* ia kam besën, e di se zgjedhin me vëmendje dhe ua jap një mundësi.

E nis leximin me atë ndjesinë që kam gjithmonë kur më mbërrin copa e akullit në dhëmbë, ndërsa çoj gotën e limonadës. Ky titull. Këta emra. Emrat e përveçëm në poezi më irritojnë. Edhe më duket se është bërë modë, gjithandej këta emra. Arrij ta përfundoj pyetjen në krye se cili është qëllimi i emrave, a mos duan t’i individualizojnë poezitë a si? Por mua veç m’i bëjnë të huaj, kjo nuk është poezia ime, është e personit për të cilin flitet. Veçse kam vendosur ta lexoj deri në fund dhe poezitë duhen trajtuar me respekt. E shtyj akullin me gjuhë jashtë gojës dhe pi një gllënjë nga pija. Lexoje edhe ti tashti, të lutem:

Abuk Ajou

Abuk Ajou kishte uri. Uri të vërtetë.

*Ndoqi zërin e urisë së vërtetë që mbërriti në qendër,
i kaloi përmes rrugës së kuqe të Bahr al Ghazal,
rreshqanthe i shkoi dheut ngjyrë ndryshk e aty vuri me kujdes
lëkurën, kockat
e kokën.*

*Që të jetonte gjatë ka qeshur pak,
pak ka thënë,
asnjë pëshpërimë ka pëshpëritur
e ka kursyer jetë për tre ditë e tre net.*

*Shpesh i kalonin pranë djem të rinj,
vajza shtatlarta me sy të mëdhenj e të errët,
burra poterexhinj, të zinj edhe ata,
por asnjë nuk ia ciku ballin,
asnjë nuk i tha:
- Përhëndetje Abuk Ajoul! A po vdes mirë?*

*Të marrosur nga e njëjta uri
ndiqnin renë
që mbi Lumin e Gazelës kullonte
dritën e zbehtë mbi ujëra të turbullt.*

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Poezia është shumë dramatike. Fillon me uri, uri të vërtetë. Uria është aq e vërtetë sa e vdes Abuk Ajou-n. Vdekja është gjithnjë prova finale e së vërtetës. Abuk Ajou vjen nga Bahr al Ghazal, Lumi i Gazelës. Më duhet të gjej se ku ndodhet. Në Sudan, ndodhet në Sudan. Një lum i tharë, një nga rrjedhat e Nilit. Edhe një regjion i tërë quhet kështu. Abuk Ajou vjen nga Sudani. Poezia befas më del nga duart. Duhet të di më shumë. Mos është ndonjë person i njohur, një vdekje e njohur? *Google* më jep vetëm Abuk Ajou në faqet e *Facebook*-ut. Atëherë nis të kontrolloj mos është emër burri a gruaje. Dhe më dalin nga të dyja palët. Stop! Më duhet t'i përmbahem leximit të vargut. Abuk Ajou kishte uri. Uri të vërtetë. Poezia nis me një konstatim të thjeshtë edhe pse dramatik. Por që në vargun e dytë, uria është vetë personifikimi i Abukut. Ai (ajo?) ia ndjek zërin dhe bëhet një me të, ecën me të, zvarritet dhe mandej palon me kujdes lëkurën dhe kokat. Uria personifikohet në një qenie të vërtetë që ka zë.

Strofa e dytë e thyen ritmin me një fjali të nënrenditur si fillim. Kjo thyerje, si rëndom, i jep poezisë një fokus në fjalën që thyen, në këtë rast “jetë”. Abuk Ajou kishte uri dhe kursente jetën që të jetonte pak më gjatë. Nuk qeshte, nuk fliste. Abuk Ajou ishte vetëm uri.

Dhe mandej, papritur, fokusi zgjerohet. Nuk shohim vetëm urinë e shtrirë përtokë përmes rrugës së kuqe të Bahr al Ghazal, por edhe kalimtarët. Jeta e kursyer e Abuk Ajout shkon përbri jetës së pakursyer: vajza dhe djem të rinj shtatlartë, symëdhenj dhe burra poterexhinj, të zinj edhe ata. Por jeta e pakursyer nuk ka as veshë, as sy për orët e kursyera të vdekjes.

E megjithatë, të gjithë të nisur drejt të njëjtit horizont, të gjitha udhët dhe rrugët të çojnë tek i njëjti fat. Mbi të gjithë, e njëjta re që kullon dritë të zbehtë mbi lumin e turbullt.

Pamja bëhet sërish dramatike. Nuk është vetëm uria e vërtetë në skenë, ajo që ta gërryen stomakun dhe ta përqendron esencën e qenies në një copë bukë. Një uri tjetër e turbullon lexuesin, ajo që avitet ngadalë dhe e prek atë jo vetëm në telat e mëshirës, që kur dridhen, e shtyjnë t'ia falë copën e bukës lypësit. Kjo është uria për me qenë njeri, uria për dinjitet, për vështrime njerëzore. Uria e vërtetë e Abuk-ut.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Leximi i dytë, zakonisht nis e t'i zbulon sekretet e realizimit, është leximi i teknikës. Shumica e poezive nuk kanë sekrete, kanë vetëm metafora. Por talenti i vërtetë nuk qëndron në metaforat. Mendja e njeriut është një prehër i pafund metaforash. Talenti i vërtetë qëndron në krijimin, shpesh spontan, të një ndërthurje metaforash, gjendjesh dhe emocioneesh që e rishpikin poezinë në mendjen e lexuesit. Lexuesi e gjen veten duke zbërthyer teknikën e poezisë njëkohësisht që zbërthen veten. Në këtë pikë, poezia duhet lexuar me zë të lartë. Kthehu dhe lexoje edhe një herë, të lutem!

A po vdes mirë? A e ndien edhe ti si jehon ende në ajër kjo pyetje? Si mund të jehojë në ajër një pyetje që nuk iu shtrua kurrë atij që vdiq i braktisur?

Pamja teatrale e leximit të parë, me skenën ku një personazh me emër të huaj shkon rrëshqanthi, të tjerë anonimë që parakalojnë me zhurmë, qielli që rëndon me re dhe dritat diku që imitojnë një lum të turbullt, me metaforat e urive që përshkojnë skenën me kosat e tyre vringëllitëse, kjo pamje papritmas shuhet në lexim të dytë.

A po vdes mirë? Kjo pyetje në qendër të poezisë, që në lexim të parë veç m'u duk se i shërbente pasqyrimin të idesë së indiferentizmit ndaj vuajtjes, sepse askush nuk e drejtoi,

papritmas është ajo që në lexim të dytë, shtyp ON AIR të poezisë. Pse kështu? Së pari, sepse në ndryshim nga ato metaforat e lexueshme të sipërfaqes, që shkrihen në gojë thjesht, kjo është një figurë e çmendur. “Vdes” dhe “mirë” të pranëvendosura janë një çmenduri që e thyen sërish poezinë, e thyen cepa-cepa si atë bukën e thekrës që ua përfytyrojmë në duar të varfërve. Pyetja nënkupton se ka një mënyrë për të vdekur mirë. Mbas tri ditësh dhe tri netësh, nuk ka mbetur tjetër veç dëshira për ta dëgjuar një zë që në mos tjetër pyet “a po vdes mirë”. Shpëtim nuk ka, ka vetëm vdekje megjithatë. Por të paktën një zë që pyet?

Së dyti, ajo që e bën pyetjen qendrore në poezi është pikërisht thënia e saj. Se asnjëri nuk e tha, por poezia po. Dhe e tha në qendër, atëherë kur lexuesi i kishte ulur gardhiqet që e ruajnë nga prekja emocionale. E tha kur lexuesi po provonte mëshirë. *A po vdes mirë?* Pyetja vjen kaq papritur, sa ka forcë dhe aftësi të gjejë zbuluar pjesën e butë të lexuesit. Dhe e godet: *A po vdes mirë?* Skena është e kthyer me fytyrë nga lexuesi tashmë, lexuesi në qendër, lexuesi Abuku. Në terrin e teatrit shihet vetëm shenja e kuqe ON AIR, maska e lexuesit dhe jehona e pyetjes që vjen nga të gjitha anët. Po ti? Po ti? Po ti?

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Poezia e mirë e shtyn lexuesin pashmangshëm në një lexim të tretë, leximin e mendimit. Sepse poezia nuk është vetëm teknikë dhe fjalë. Poezia është mendim. Poetët e talentuar mbjellin mendime dhe përjetime në ne. Leximi i tretë e ndihmon lexuesin të ndjekë fillin e mendimit të poetit dhe fillin e mendimit të vet.

Isha e bindur se në lexim të tretë, mendimet do të më vërtiteshin rreth jetës së vështirë të refugjatëve. Ndërsa përsiatjet me shpien në një kah krejt tjetër. Më qëllon shumë rrallë të lexoj poezi të mirë të angazhuar në shqip. Dhe ky lexim më shtyn ta

festoj me një përsiatje të re rreth poezisë dhe takimit në një pikë të boshteve të saj.

Poezia dhe leximi i saj, për fat, në epokën e rrjeteve shoqërore nuk është më pronë vetëm e banorëve të Olimpik poetik. Olimpika zbritur në tokë. Perënditë pikëllohen, sepse po ngatërrohen me të vdekshmit, të vdekshmit tallen me ata që u duket vetja perëndi, shiu i Zeusit bie mbi të gjithë, detet e poezisë janë mbushur plot e përplot. Për mua, ky është një fenomen i natyrshëm. Kam menduar gjithmonë se ne lindim të gjithë poetë, njeriu është një mrekulli më vete, por disa prej nesh e humbin këtë aftësi, sepse nuk e shfrytëzojnë. Është e vërtetë se po bie shi pa pushim, se po “shitet” gjithandej ilaçi i poezisë si në romanin e Shkëlqim Çelës, por kjo nuk e hollon poezinë e mirë. Poezia e mirë është gjithmonë aty ku priten të gjitha boshtet që përbëjnë parakushtet e saj. Vetëm se ne si lexues duhet të mësohemi ta dallojmë. Aty ku priten tri boshte, ndjeshmëria, shpirti i madh dhe forca shprehëse estetike, aty krijohet një poezi që lexuesi e ndien si t’i fliste drejtpërdrejt, nga brenda. Kjo është poezia që e shkokëlon përjetimin molekulë më molekulë, pa frikë, as nga vetvetja as nga turjela e leximit. Aty lind poezia që e shtyn lexuesin të njohë veten më mirë, poezia që e ngre lexuesin një nivel më lart, poezia e mirë, e bukur, ose “poezia e tri boshteve”, nëse më lejohet të shpik një term. Shqipja është e pasur me poezi të tilla sot, poezi që e bëjnë lexuesin të ndihet shpirtlexuar dhe njëkohësisht të kultivuar, edhe pse sinqeriteti pa epitete e cilësime është një fenomen i ri për ne lexuesit e mbrujtur me estetikën e sinqeritetit socialist. Dhe kjo është e rëndësishme, poezitë e mira shpirtlexuese na përmirësojnë jetën dhe përjetimin e vetvetes. Shqipja është e pasur, sigurisht, edhe me poezi të mira ku boshtet nuk e gjejnë kurrë njëri-tjetrin, por shkojnë paralel: p.sh., poezi që janë të bukura estetikisht dhe shprehin një ndjenjë të vërtetë, por u mungon shpirtgjanësia (se “shpirtgjerësia” më duket e ngushtë si formë) dhe e lënë lexuesin jashtë. Mirë që

bie edhe ky shi, sepse na përmirëson shijen estetike. Sidoqoftë, simbas perspektivës sime, pika e takimit të boshteve duhet të ndodhë brenda leximit.

Dhe mandej kemi kategorinë ku hyn kjo poezi që po lexojmë së bashku. Është e rrallë në shqip, sepse kërkon jo vetëm ndjeshmëri, shpirt të madh dhe forcë estetike, por kërkon edhe një variabël plus. Kërkon një bosht të katërt që gjendet kollaj në jetën e përditshme, por që është kaq i vështirë të takojë tri boshtet e tjera në një pikë. Kërkon angazhim shoqëror. Angazhim të sinqertë. Të tillë siç e ka Gentjana Minga apo Shqiptar Oseku (lexo p.sh. “99 emra”). Nëse lloji i poezisë së mësipërme, ajo pika ku priten tri boshte, e hulumton vetveten në një mënyrë që e shtyn lexuesin të njëjtësohet me të, poezia e katër boshteve del nga vetvetja dhe njëjtësohet me njeriun a fenomenin shoqëror që e intereson. Këtu ndodh ai procesi i njëjtësimit të njëjtësimit, që është gati magjik kur ndodh, por që ndodh kaq rrallë:

poezia njëjtësohet me objektin + lexuesi njëjtësohet me poezinë = lexuesi njëjtësohet me objektin.

Ndodh ajo që njihet si forca frymëzuese e letërsisë, që mund ta shtyjë një shoqëri përpara. Që të ndodhë, duhet që poezia të jetë e sinqertë në angazhimin e vet. Shqipja është e pasur me poezi të angazhuara, por që u mungon shpirtgjanësia e përfshirjes së lexuesit në përjetim, poezi që duan vetëm të tregojnë, edhe pse bukur. Lexuesi shqiptar, që i ka shqisat poetike copë-copë nga propaganda politike e lirikat e ngarkuara me emocione personale, ka nevojë ta ndiejë se poezia e ka zemrën tek objekti, se njëjtësohet me të. Përndryshe nuk mund të njëjtësohet, përndryshe përvoja e përçudnuar estetike e mëparshme, do ta mbajë larg. Poezia e katër boshteve e bën lexuesin të ndihet a thua se është vetë objekti i poezisë, në ndryshim nga poezia e tri boshteve, ku lexuesi ndihet a thua se e ka shkruar ai/ajo vetë poezinë, sepse i duket se flet për të.

Të dyja këto lloje poezish të mira ndërhyjnë dhe hyjnë në lexuesin. Janë si lumenjtë, që nuk janë aty vetëm për të rrjedhur në det, por edhe për të krijuar shtratin e vet me brigje të banuara përgjatë gjithë rrugëtimit.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Në leximin e katërt, lexuesi e njeh mirë poezinë, tashmë. Nëse ka mbërritur deri këtu e do këtë poezi, e dashuron. Për temën, gjuhën poetike, për mjeshtërinë e realizimit, për fillin e mendimit, por sidomos sepse në leximin e katërt ka për ta ndier poezinë deri në fund, ka për t'ia ndier dehjen, magjinë, do të jetë a thua se e ka shkruar vetë. Leximi i katërt është leximi i vetes.

A thua kemi qenë gjithmonë kështu të pamëshirshëm ndaj njëri-tjetrit? A thua mirësia që treguan vendet e pasura ndaj të huajve për një kohë s' ishte veç pasojë e euforisë së fitimit të luftës? Tashti ngado që hedh sytë, veç urrejtje për të huaj. Ata shkojnë dhe mbajnë mbi shpinë fajet e një bote që nuk gjen rehati pa u nderur flakë. Uria për bukë dhe uria për dinjitet dalin e lypin çdo ditë edhe rrugës sime. A po vdes mirë?

Leximi i poezisë ”Fëmija” të Eduart Ymerit

Fëmija

*Atje luan me çelësin e kohës sonë.
E hedh nëpër ferra,
(kërkoj këtu ta gjej të më hapet dera),
dhe mbin në lëndinën me luledede,
(pranë kam vetëm det,
në mes shtëpia e reve
nxin një fletë).*

*Në fund të lojës,
(është një fillim, të mësoj sekretet e bojës),
ma jep në dorë.
I bëj dhuratë një orë.*

*E kupton dhe largohet të më mbajë gjallë.
Sa herë ikën, ai edhe unë vëmë duart në ballë.*

(Facebook, 2019)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

E kanë një magji të vetën poezitë që luajnë me simbole dhe metafora, me analogji dhe kuptime të dyfishta, të nënkuptueshme a të mbikuptueshme. Para tyre ndihem gjithnjë si para gjëegjzave të fëmijërisë, e mbushur me pritshmërinë e zbulësës. Ndryshimi është se gjëegjzat e kanë zgjidhjen e përcaktuar, të paracaktuar, kurse poezitë e formojnë zgjidhjen dhe interpretimin te lexuesi, në lexuesin. Ndjesinë e gjëegjzës ma shton edhe më tepër rima, që nis pak shkujdesshëm në strofën e parë, por mban frenat e vargjeve në vazhdim.

Fëmija atje në poezi luan me çelësin e kohës sonë. Çelësi që çel kohën është në duart e fëmijës, por fëmija që e ka kohën përpara, nuk ia di vlerën dhe e hedh në ferra. Fëmijëria që, e parë prej së largu, edhe ferrat i ka luledele. Fëmija atje luan me çelësin e kohës sonë.

Unë këtu nxin fletë, shkruan, mëson sekretet e bojës, kërkon t'i çelet dera, banon në shtëpinë e reve, i rrethuar nga deti. Fëmija ia lë çelësin në dorë. Fundi i lojës është fillimi i shkrimit. Dera hapet dhe frymëzimi merr bojë. Por në të njëjtin çast, fillon edhe numërimi i kohës, i bëj dhuratë një orë. Dhe me numërimin fillon fundi. E kupton dhe largohet të më mbajë gjallë. Largohet. Ikën. Sa herë ikën. Sepse ka ikur dhe është kthyer shumë herë. Sepse ky proces përsëritet gjithherë, jo vetëm një herë. Si kurdisja e orës.

Fëmija atje luan me çelësin e kohës sonë. Jo çelësin që çel, por çelësin që kurdis. Loja e kurdisjes është gjithnjë argëtuese. Më kujtohet gëzimi i qenushëve prej pelushi, që merrnin jetë nga kurdisja. Fillimi dhe fundi i përcaktuar i kohës. Një çelës për një ekzistencë. Fëmijëria që kurdis frymëzimin, herë dhe gjithherë. Frymëzimi që kurdis kohën, herë dhe gjithherë. Kohën tonë. Ai dhe unë. Vëmë duart në ballë? Në kuptimin e habitës, si atëherë

kur i bie ballit me dorë? Në kuptimin e dëshpërimit, si atëherë kur e kap kryet në grushte? Në kuptimin e përsiatjes, si atëherë kur biem në mendime me ballin ndër duar? Mua më vjen si dorë në ballin e nxehtë të kllapisë. Kllapia që vjen në frymëzim dhe largohet që të më mbajë gjallë. Por fëmija atje luan me çelësin e kohës sonë. Sonë? Ne?

Më duhet ta lexoj edhe një herë. A e lexojmë bashkë?

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Leximi im i dytë i kësaj poezie është i gjithi një lexim në kërkim të kryefjalës: Kush? Kush është?

Kush luan me çelësin e kohës sonë? Fëmija.

Kush e hedh në ferra? Fëmija.

Kush kërkon ta gjejë? Unë.

Kush mëson sekretet e bojës? Unë.

Kush ma jep çelësin në dorë? Fëmija.

Kush i bën dhuratë një orë? Unë.

Kush e kupton dhe largohet? Fëmija.

Kush ikën? Fëmija.

Kush vë duart në ballë? Ai dhe unë.

Ai? Kush është ai? Fëmija? Por fëmija nuk ishte pjesë e "ne"-së së fillimit të koha jonë: Fëmija atje luan me çelësin e kohës sonë. "Ne" është një entitet tjetër, është ai dhe unë.

Shumësi në përemrin e vargut të parë dhe në foljen e vargut të fundit janë gjëgjëzë më vete:

Sa herë ikën, ai edhe unë vëmë duart në ballë. Kush është?

Tek unë vijmë si tri entitete:

Fëmija, në rolin e fëmijës.

Ai, në rolin e poetit.

Unë, në rolin e frymëzimit.

Kur e lexoj poezinë kështu, me rolet e ndara në këtë mënyrë,

më duket se gjithçka bie në vendin e vet. Provoje edhe ti! Lexoje poezinë nga perspektiva e një entiteti të tretë. Frymëzimi pret t'i çelet dera në shtëpinë e tij irrealë prej resh, në mes të detit. Frymëzimi e ka kohën e matur. Frymëzimi është uni i leximit tim.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

A është poezia një gjëgjëzë? A kërkon ta interpretojmë, t'ia gjejmë çelësin që çel kuptimin e saj?

Apo mjafton ta shijojmë ashtu siç është? Po, a dimë ta shijojmë poezinë nëse nuk e mësojmë “veshin” me leximin e saj? Për shembull, e shijove më fort këtë poezi pa e ndjekur fillin e leximit tim, apo mbasi e ndoqe atë? A është kritiku një Arianë që lëshon një fill të kuq, që mund ta ndjekësh si lexues për t'u orientuar?

Unë nuk kam përgjigje përfundimtare. Por mua më pëlqen me endë fije, të shumëngjyrshme. Për mua, poezia e mirë është një kënaqësi e veçantë, sepse më fton ta ndjek, ta zbuloj, ta gjurmoj, ta gjuaj, ta dua dhe ta bëj timen. Është si një akt dashurie mes poezisë dhe lexuesit. Ti ndoshta pyet veten, po poeti? A nuk është poeti ai që e di më mirë se lexuesi se çka dashur të thotë? Unë nuk besoj në ekskluzivitetin e poetit, ashtu si nuk besoj në ekskluzivitetin e një leximi. Besoj në ekskluzivitetin e lexuesit. Prandaj dua ta nxis lexuesin që ta marrë situatën në kontroll, ta marrë poezinë në dorë dhe ta lexojë me zë të lartë, në të dyja kuptimet:

- lexim në kuptimin e deklamimit;
- lexim në kuptimin e interpretimit.

Ndoshta filli mandej të çon te poeti. Mua më çon gjithnjë te vetja ime.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

– Pa zë, heshtur numëron, askush punën s’ia mohon. Kush është?

– Ora.

Leximi i poezisë “Fustani” të Ardita Jatrut

Fustani

*Nëna ime kishte vetëm një fustan
e lante natën dhe e thante pranë furnelës.
Ditën e vishte me aromë të re.
Nuk e pyeta asnjëherë pse nuk blinte një të dytë.
Nuk deshta të kishte një të dytë.
Unë ashtu e njoha
me fustanin lule rozë,
deri te gjunjët.
Kur bleu një këmishë mëndafshi të verdhë
e preva copash natën me gërshërë
dhe mbusha xhepat.
Nëna heshti dy ditë
e unë gëzohesha nga brenda
që ajo vishte prapë të njëjtin fustan
dhe i përsërisja vetes,
sa dua t'i ngjaj.*

*Tani kam filluar të kuptoj nënën.
Pikëpyetjet e atëhershme i zgjidha,
nga dalin ofshamat
kam filluar të kuptoj
dhe vetëm pse copëtohej,
pse luftonte vetëm.
Fundja pse duhet të kishte një fustan.
Për të gjitha këto, kuptoj një gjë,
rritem dhe i ngjaj asaj
por me fustane të ndryshme
luftoj vetë i dytë
dhe stinët e mia thinjen para pasqyrës.*

(“66 kg vetmi”, Tiranë, 2015)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Poezia për nënën është një poezi që nuk resht kurrë së shkruari. Himnizimi i figurës së saj duket sikur është një nevojë e brendshme që na kap të gjithëve një ditë. Por kjo nuk është një poezi e zakonshme për nënën, e mbushur me fjalë të mëdha dhe metafora të shkëlqyeshme që më shumë hedhin dritë mbi birin, se sa mbi vetë nënën. Himnizimi i figurës së saj i besohet një rrëfimi të thjeshtë të një historie në thelb tragjike: një nënë e varfër, që ka vetëm një fustan. Historia e një nëne të heshtur që lufton vetëm, e mbështjellë në këtë fustan me lule rozë, që i mbërrin deri te gjunjët. Fustanin që lahet në mbrëmje, thahet mbi furnelë dhe vishet në mëngjes me aromë të re. Përbri i qëndron një vajzë e vogël për të cilën fustani dhe e ëma janë një. Një vajzë e vogël që dëshiron të jetë si e ëma, që dëshiron ta veshë vetë atë fustan, që për lojalitet ndaj kësaj dashurie pret me gërshtë këmbësorë të verdhë.

Poezia mbahet për thjeshtësinë e vet. E gjitha ka në sipërfaqe vetëm një metaforë: *stinët e mia thinjen*.

Dhe kjo nuk është ndonjë gjetje që të lë pa frymë. Ajo që të lë pa frymë është pikërisht thjeshtësia me të cilën rrëfëhet një fat kaq tragjik, një rrëfim që i ngjan përditshmërisë së kësaj gruaje. Një thjeshtësi që me siguri e tremb atë që pret shkëlqim nga poezia, që pret thirrjen “më shih, më shih sa poetike jam!”. Kjo poezi duket kaq indiferente, e lidhur për atë përditshmëri kaq të zakonshme që e njohim të gjithë. Dhe kjo është forca e saj, ndjeshmëria ndaj së vërtetës dhe aftësia për t’u jehuar në përvojën e lexuesit. Në kryet e lexuesit shfaqet pa dashje fustani i nënës së vet (a ndoshta këpucët, modeli i flokëve).

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Kjo është ndër poezitë tipike të thjeshta që të duket se t’i ka thënë të gjitha me leximin e parë. I ngjan atyre ndeshjeve të tenisit

në TV. A e keni parasysh publikun si i sjellin kryet automatikisht, të gjithë përnjëherësh, andej nga shkon topi? Fap-fup topi, majtas-djathtas krenat. Kështu edhe lexuesi me këtë poezi. Ulet në tribunën e publikut dhe sheh një ndeshje tenisi. Veta e tretë dhe veta e parë luajnë tenis. Ritmi është i ngjeshur, edhe në ajër ndihet lëvizja e krenave dhe përplasja e raketës për top fap-fup, fap-fup.

Veta e tretë gjuan fap:

Nëna ime kishte vetëm një fustan

Veta e parë e kthen fup:

Nuk e pyeta asnjëherë pse nuk blinte një të dytë

Fap: *Kur bleu një këmishë mëndafshi të verdhë*

Fup: *e preva copash me gërshërë dhe mbusha xhepat*

Fap: *Nëna heshti dy ditë*

Fup: *unë gëzohesha nga brenda*

që ajo vishte të njëjtin fustan

Rezultati është *Game 1* për vajzën.

Në pjesën e dytë, loja ka ndryshuar karakter. Nuk kemi më lojë një kundër një. Përbri vajzës qëndron tashmë vetja e rritur. Edhe përbri nënës është shfaqur një figurë tjetër. Tashti publiku e kupton se ajo veta e tretë e mëparshme s'ishte veçse një fustan pa fytyrë, pa zë, s'kishte veçse ca lule rozë, aromë dhe gjatësi. Përbri tashmë shfaqet gruaja. Ajo që lufton vetëm. Fustani luan përballë vajzës së vogël, ata e vazhdojnë lojën si më parë, veçse tashmë ka kaluar në sfond, fap-fup, fap-fup. Publiku e di përmendësh lojën e tyre, sepse e njeh, është e njëjta lojë për të gjithë. Por gruaja-nënë (veta e tretë) qëndron përballë vajzës-grua (veta e parë). Këto të dyja nuk luajnë, janë si dy lojtare që nuk kanë

më dëshirë të garojnë. Ato veçse vështrohen. Disa të publikut nuk e kanë kuptuar ende dhe vazhdojnë të lëvizin krenat majtas-djathtas, djathtas-majtas duke ndjekur topin. Të tjerë janë ndalur dhe shohin lojën pa raketa të figurave të reja. Vajza e rritur luan në një kohë progresive që ndihet shumë e tashme, në kohën e rritur (edhe përjetimi i së kryerës “i zgjidha” ndihet i tashëm), kurse nëna në kohën e pakryer, është një lojë në kohë, një lojë e pamundur:

Vajza: Tani kam filluar ta kuptoj nënën

Nëna: vetëm pse copëtohej

pse luftonte vetëm

pse duhej të kishte një fustan

Vajza: rritem dhe i ngjaj asaj

luftoj vetë i dytë

Dhe atëherë, STOP!, a i shikon katër figurat në fushë?

Vajza e vogël përballë fustanit me lule rozë. Edhe përkrah vajzës qëndron një fustan, veçse ky ndërron pamje gjithë kohën (i ngjaj asaj, por me fustane të ndryshme), vetja e rritur e gruas është pasqyrimi i figurës diagonal. Përballë qëndron figura e nënës, e vërteta, ajo që lufton vetëm. Gati pres që përbri t’i shfaqet brezi i tretë, një vajzë tjetër e vogël që luan tenis me fustanin/et e heshtur/a fap-fup, fap-fup. Atmosfera është shumë e tensionuar, një poezi qaramane do t’ia kishte plasur vajit përballë pamundësisë së kësaj loje, por jo kjo poezi. Kontrolli dhe përmbajtja janë totale. Kjo poezi nuk qan. Është më e fortë se kaq. Poezia luan me lexuesin, loja e vërtetë është midis ndjenjave të vetë lexuesit dhe tekstit. Vargu i fundit shfaq një pasqyrë gjigante dhe publiku e kupton, më në fund, se loja që po ndiqte, s’ ishte veçse pasqyrim i asaj që

po ndodhte në tribunë. Të gjithë janë lojtarë në lojën e rritjes, me fustane a pa fustane.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Kjo për mua është poezia e rritjes dhe e identifikimit. Fustani s'është veçse një justifikim, një petk i jashtëm, për të treguar procesin e rritjes së një vajze. E njëjta dramë zhvillohet edhe mes vetes së rritur me shumë fustane dhe vajzës së vet. Dhe kështu brez mbas brezi, vetëm fustanet ndryshojnë: bërja e gruas ndjek gjithmonë të njëjtën rrugë në shoqëritë tona, vajza sheh nënën dhe bëhet si ajo, pashmangshmërisht. Nëna hesht (nëna heshti dy ditë), vajza hesht (nuk e pyeta asnjëherë). Vajza dëshiron t'i ngjajë së ëmës, është dashuria më e lartë kjo, por me një kusht të tmerrshëm: nënës nuk i lejohet të ndryshojë rolin e vet, i lejohet vetëm të plakët, por kurrësi të mos luftojë e të mos copëtohet në rolin e vet. Në mos këmisha e verdhë do të ishte diçka tjetër që do pritej me gërshtëri. Mund të ishte prishja e darkës së nënës me të dashurin, ose prishja e takimit me shoqet, gjithçka e re që mund t'ia tërhiqte vëmendjen nënës nga vajza dhe t'ia ndryshonte rolin, ta kthente në një grua me nevojat e veta dhe me luftën e vet kundër varfërisë, që nuk e lejon të blejë një fustan të ri, nga njëra anë. Dhe nga ana tjetër, neëluftë me rolin e saj si nënë, gjithmonë nënë, kurrë më grua. Dhe nëna nuk ka të dytë përveçse në veten tënde (*luftoj vetë i dytë*).

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Fustani i nënës sime ishte i zi me lule të mëdha rozë dhe bojë qielli. Një herë e dogji duke e hekurosur dhe u detyrua t'ia hiqte prerjen e gjerë dhe ta ngushtonte, mandej i iku moda mëngëve me volang dhe i preu. Por gjithmonë i njëjti fustan, i vetmi fustan vizitash. Lumturia ime kur u rrita dhe ajo e solli nga ana tjetër dhe e përshtati për mua. Dhe stinët e mia thinjen para pasqyrës.

Leximi i poezisë “Hapa drejt dritës në fundin e këtij tuneli” të Sueton Zhugrit

*Hapa drejt dritës në fundin e këtij tuneli,
ja tek është vetmia
e regjur në pëlhura merimangash pellazgjike
dhe hije idiomash polare...
Pllakat tektonike këtu janë rrafshuar njësh me shpirtin,
si dëborë e akullit që shkriu e ujshme mbi lëkura neandërtalësh,
bashkë me varrin e diellit që zbulohet mëngjeseve e gjakon pafund
në gojën e natës nordike...
Unë dhe ti jemi të vetmit zogj gjitarë me sy të fiksuar,
Jug.*

(Facebook, 2017)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Nuk mund ta lexosh këtë poezi pa i ndier mbresat që në leximin e parë. Ose më shumë se mbresa, përshtypje, pasoja, do të thosha se kjo poezi të lë efekte, vepron që në sipërfaqe.

Efekti i parë që poezia ka te lexuesi është një efekt gjeografik, një pozicionim i qartë gjeografik: jemi në Veri, aty ku ka të folura polare, net nordike, toka të rrafshëta, gjurmë neandertalësh dhe dëborë e akuj.

Efekti i dytë është ai i mbylljes, një mbyllje e rrumbullakët prej tuneli me një rreze drite diku në fund, që e mbërrin lexuesin nëpërmjet formave katrorë-katrorë të rrjetave të merimangave dhe hijeve. Një dritë e kuqërremtë e mbyllët, ngjyrë gjakimi.

Efekti i tretë është ai i një bote në kontrast, Veriu dhe Jugu, nordik dhe pellazgjik, “këtu” dhe prandaj një “atje” e nënkuptuar. Një kontrast që megjithëse i nënvizuar me fjalë rri pak si nën shtresë dhe sikur të fton ta mendosh më gjatë. Është nga ato fijet që të lidhen dhe të bëjnë të rikthehesh në lexim.

Poezia ka në lexuesin edhe një efekt anësor, që nuk di si ta quaj, ndoshta primordial. Ky efekt më krijohet nga përdorimi i disa fjalëve si “pellazgjik”, “pllaka tektonike”, “neandertal” që të krijojnë ndjesinë e një bote të kahershme. Si me qenë brenda një shpelle, jo tuneli, me vizatime prehistorike ndër mure dhe me varre e fosile qosheve. Një atmosferë përrallash të vjetra me Lugat dhe Kukudh.

Disa poezi më shtyjnë t’i lexoj me zë për t’i marrë fjalët në gojë e për t’ua ndier shijen. Disa poezi më shtyjnë t’i recitoj për t’ua ndier ritmin, kadencat, thyerjet e vargjeve. Ka mandej poezi që i mësoj përmendësh. Dhe ka poezi, si kjo, që më shtyjnë të kërkoj lapsin tim të mësueses së letërsisë dhe të ulem e t’ia analizoj metaforat përbri vargjeve. Sepse ka metafora që rrinë pulsojnë

e të pulsojnë në krye si misrat *popcorn*, në qoftë se nuk i lë të shpërthejnë të lira e të ta tregojnë deri në fund magjinë e tyre. Ja për shembull, ky varg, i dashur nxënës:

bashkë me varrin e diellit që zbulohet mëngjeseve e gjakon pafund në gojën e natës nordike...

“Varri i diellit”, kjo metaforë e hershme e përdorur për perëndimin, në shqip e njohur sidomos ndër arbëreshë si “varra e diellit”, plotësohet me “që zbulohet mëngjeseve” për të rrëfyer mëngjesin. Mëngjesi, pra, si një varr i zbuluar. Dhe jo vetëm kaq. Ky nuk është një varr i vdekur, siç mund të pritët. Por një varr që gjakon në gojë. “Varri” si varrë, një varrë e dhimbshme, siç janë plagët në gojë. Dhe jo vetëm kaq, por një varrë që gjakon pafund. Gjakim si dhimbje, si humbje, por edhe si kuqërim i mëngjesit. Dhe “goja e natës” – goja, diçka që hapet për të gëlltitur, një tunel i përmbysur. Vargu fillon me errësirën e varrit dhe përfundon me errësirën e natës nordike. Vargu jeton në një terr total, por është njëkohësisht një terr i përgjakur, me njolla të kuqërremta që më shumë shënojnë dhimbjen për dritë se sa dritë. Është nata e varrit. Dielli duket si ai Lugati i historive të vjetra që vjen vetëm për të çjerrë pëlhurat. Pëlhurat e vetmisë.

Vargjet e tjera mund t’i analizosh vetë, apo jo? Mund të kalosh gjithë pasditen duke rrëmuar e kthyer përmbys metaforat e kësaj poezie. Mos lër gur pa lëvizur! Por mos harro të nënvizosh efektin dramatik të mbylljes së poezisë me “Jug”. Nga ana ritmike, është një thyerje totale që të shtyn ta lexosh poezinë nga fillimi për të kuptuar se çfarë ndodhi. Nga ana tematike, është pozicionimi i poezisë në një hapësirë e emigrimit, Jugu i mërguar në Veri, drita e mërguar në terr, poeti i mërguar në vetmi.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Nuk po zgjatem shumë me metaforat e sipërfaqes, sepse dua të të tregoj diçka tjetër: a i sheh lakuriqët e natës?

... të vetmit zogj gjitarë

Rrinë të varur lart e poshtë siç e kanë zakon, në tavanin e tunelit të poezisë. Tuneli që, në anglishten e vjetër, kishte edhe domethënien e një kafazi a rrjete për të zënë zogj. Edhe këtu, drita hyn nëpër rrjetat e pezhishkave. Rrinë aty të strukur, si në kurth, siç rrinë lakuriqët nordikë duke pritur të kalojë dimri. Rrinë aty gjysmë të verbër. Përveç poetit, i vetmi lakuriq nate me sy të fiksuar në syrin e diellit, në syrin e Jugut, lakuriqit tjetër:

Unë dhe ti jemi të vetmit zogj gjitarë me sy të fiksuar

Ky lakuriq nate, i varur ashtu nga këmbët, siç e kanë zakon lakuriqët e natës, më bën ta shoh poezinë nga një perspektivë tjetër, kryeposhtë, sepse këtu varri është në qiell. Më shtyn ta lexoj poezinë nga poshtë-lart, ta filloj leximin me thirrjen:

Jug

Unë dhe ti jemi të vetmit zogj gjitarë me sy të fiksuar

Të luaj mandej me metaforën e gjakut:

bashkë me varrin e diellit që zbulohet mëngjeseve e gjakon pafund në gojën e natës nordike

si dëborë e akullt që shkriu e ujshme mbi lëkura neandertalësh

Gjaku që rrjedh si dëborë që shkrihet, një kontrast i ri merr jetë aty, ai midis ngrohtësisë së gjakimit dhe ftohtësisë së dëborës së shkrirë, që veçse ia shton efektin dramatik poezisë.

Edhe pikëllimi i hapësirave rrafshe përforcohet në lexim

kryeposhtë, duke e vënë edhe më në dukje vetminë e të huajit pellazgjik rrethuar me idioma nordike. Vetmia (që edhe në këtë version rikthehet e mbështetur nga “të vetmit”, që në poezi përdoret për të nënvizuar ndjesinë e vetmisë), e lexuar kryeposhtë, i nder pëlhurat e saj drejt e në shpirt:

*Pllakat tektonike këtu janë rrafshuar njësh me shpirtin
ja tek është vetmia
e regjur në pëlhura merimangash pellazgjike
dhe hije idiomash polare...*

Dhe fundi, i fokusuar më shumë në dëgjim se në shikim, në hapat që shkojnë drejt dritës:

Hapa drejt dritës në fundin e këtij tuneli.

Lakuriqët e natës kanë një dëgjim të jashtëzakonshëm, lëshojnë tinguj të pakapshëm nga veshët njerëzorë dhe orientohen me dëgjim.

Mbasi e ke lexuar poezinë disa herë, mund të shohësh se si leximet nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart bëhen si palimseste të njëri-tjetrit, që e përforcojnë më tepër temën e poezisë: tëhuajëzimi.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Këtë poezi e kam lexuar para dy-tre vjetësh dhe që atëherë e kam pasur në mendje si poezia e lakuriqit të natës. Çfarë është lakuriqi i natës? Gjuan natën. Fle ditën. Është gati i verbër. Jeton në koloni. Është i vetmi gjitar që fluturon. Është një qenie në kufi mes dy klasifikimesh, jo krejtësisht zog, jo krejtësisht gjitar. Një qenie më vete, në kapërcyell.

A është lakuriqi i natës një metaforë për të huajin, në kuptimin

e emigrantit? Lexuesi mund të zgjedhë vetë cilën fletë të shfletojë. Poezia mund të lexohet si tëhuajëzimi i emigrantit të përmalluar mbas Jugut në një botë të ftohtë. Mua më pëlqen ta lexoj si metaforë për tëhuajëzimin, *aliation*, si fenomen shoqëror. Tëhuajëzimi është ajo ndjesia e të qenit ndryshe nga të tjerët dhe, prandaj, i përjashtuar nga tryeza e dritës. Tëhuajëzimi ka të bëjë me ndjesinë e të mospërkuturit, mospërkatësisë, ndjesinë e të mbeturit jashtë. Izolim nga klasifikimet, përkatësi vetëm me ata të llojit të vet. Tëhuajëzimi shoqërohet shpesh me një perceptim të realitetit të kushtëzuar pikërisht nga izolimi. Një rreth vicioz, një botë e mbyllur, rrethore, një tunel i errët.

Mund të lexohet edhe si tëhuajëzim nga vetvetja. Në fund të fundit, të gjithë ne lindim me një të huaj brenda vetes, të cilin mësojmë ta njohim përgjatë gjithë jetës, ta zbusim, ta përkufizojmë, ta burgosim e ta mbyllim mbas kafazeve të rregullave dhe përgjegjësive.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Nuk di nëse lëshonin ndonjë tingull të veçantë që unë arrija ta kapja, a ndoshta ishte vetëm përplasja e krahëve. Sidoqoftë, i dëgjoja gjithmonë lakuriqët e natës kur merrnin vrull drejt flokëve të mi, atje në verandën e fëmijërisë. Kështu, vrapoja brenda në kohë për t'i shmangur. Këtu, lakuriqët e natës janë të heshtur, krejt të heshtur. Të gjallë, por të heshtur si vdekja. Një moment je e ulur e qetë në verandë dhe shijon natën e verës dhe në tjetrin vrapon e trembur nëpër oborr me një send të çmendur që të shtrëngohet fort për floku dhe nuk të lëshon së gjalli.

**Leximi i poezisë “Hapat e rëndë në korridor”
të Lindita Ahmetit**

Hapat e rëndë në korridor

Kërcëllojnë dyert

E fqinjëve

Pastaj heshtje

Sërish dëgjohen hapa

Të rëndë

Në korridor

O Zot, sa frikë nga rrethimi

Bota

Mbështetet mbi ditën e nesërme

Këtu

Atje

Majtas, djathtas

Majë piramide

*Të dashurit e mi
Ma kanë lënë
Vetminë
Një përshëndetje të lehtë
Çao
Mos u mërzit
Një buzëqeshje të vogël
Rëndomësie
Dhe kanë shkuar
Në gobi
Të mbledhin gurë të rrallë shkretëtire*

*Fshehtësitë
Që të prridhin
Dëshirat
Dhe mallëngjimi
Që zemrën ta copëtojnë
Vallëzojnë para meje*

*Të afrohet një hije
E tmerrshme
Por edhe çuni i ëndërruar*

Kënga e pakënduar

Erosi lazdran

Të flasin

Të flasin

Lotët t'i shtrydhin

Prej syrit të shkruar

O Shqipëri, Shqipëri

Zgjatma dorën

Se jam vetëm

Po pas gjëmës sime bie heshtja

Druri i shpresës së mirë hesht

Korbat mburrin zogjtë e vet

Prej degëve të tij

Dhe lëshojnë glasa

Teposhtë

(KULTPOINT, 2017:

<http://www.kultpoint-albania.com/linditaahmeti>)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Kjo poezi më vjen si dramë, ose si film dramatik, që në sipërfaqe. Për dramaticitetin e veprimit dhe të atmosferës. Për karakterin skenik, çdo strofë përcjell një skenë të re. Lexuesi, diku në errësirën e kinemasë a platesë, ndjek me zemër të ngrirë dhe lot në sy atë që po ndodh.

Skena 1:

Unë përfytyroj menjëherë një dhomë. E di se ky përfytyrim më vjen nga lexime të mëhershme nga kjo poete, por edhe këtu më supozohet një dhomë. Skena e parë zhvillohet në terr. Asgjë nuk shihet, vetëm dëgjohet. Dyert e fqinjëve përplasen kërcëllueshëm, mandej heshtje. Kërcëllimi, intensiteti i kësaj fjale krijon menjëherë një atmosferë shumë kërcënuese. Mandej dëgjohen hapa të rëndë në korridor. Sërish. Përsëritja e të njëjtëve hapa të rëndë; po afrohen apo po largohen? Frikë nga rrethimi. Vetë korridori është rrethim, izolim ndaj kësaj dhome të supozuar ku rri poetja dhe përgjon në ankth, me frikë, zhurmat përreth. Gjëma e saj e parë dëgjohet “O Zot!”.

Skena 2:

Bota vazhdon me të sajën, si gjithmonë. Diku përtej kësaj dhome të shtetrrrethuar, bota vazhdon dhe mbështetet mbi ditën e nesërme. Po të isha regjisore, do të përsillja nëpër skenë drita shumëngjyrëshe që nuk ndalen. Një e nesërme që ndodhet gjithkund, këtu dhe atje, majtas dhe djathtas ose majë piramide. Bota nuk ngutet. Sepse bota nuk i dëgjon hapat e rëndë kërcënues të fqinjëve. Nuk ka veshë për të dëgjuar kërcëllimin e dyerve të tyre. Duhet të jesh brenda asaj dhome për ta kuptuar kërcënimin.

Skena 3:

Njerëzit e dashur kanë ikur. E kanë lënë vetëm si hiçkurrmosgjë, sikur ikja dhe braktisja të ishin vogëlsira në krahasim me rrugëtimin e tyre. Një “çao” dhe një buzëqeshje të vogël, sa për t’i kujtuar se edhe ajo i ka diku njerëzit e dashur. Por ata janë në kërkim të një jete tjetër, më interesante, drejt shkretëtirës së Gobit, shkretëtirës që rritet dhe zmadhohet përherë e më shumë dhe një ditë do të pushtojë krejt rruzullin, si etja për gurë të rrallë e të çmuar. E kanë lënë këtu vetëm, të rrethuar nga fqinj kërcënues dhe vetë kanë marrë rrugët e Mongolisë.

Skena 4:

Vetëm. Tashmë poetja është vetëm. E ulur në dhomën e saj të rrethuar me korridorin kërcënues. Para saj prihet një valle makabre: fshehtësitë *prridhin* (sa fjalë e bukur kjo, do të thotë “u zënë frymën”) dëshirave dhe mallëngjimi e çan zemrën copa-copa. Vallëzojnë para saj. Ajo veç i ndjek me sy.

Skena 5:

Tashti sikur u ndez një radio diku dhe një motiv popullor dëgjohet (o moj ti me sy të shkruar) a mitologjik me Erosin, që i flet si hije, si çun i ëndërruar, si këngë e pakënduar, e perealizuar, e palazduar, që ia përлотin edhe më syrin e shkruar. Ajri trashet nga ndjenja e pikëllimit, e dëshpërimit, e pafuqisë.

Skena 6:

Një gjëmë e re i shpërthen papritmas. E para ishte “O Zot!”. A thua është e dyta “O nanë!”:

O Shqipëri, Shqipëri

Zgjatma dorën

Se jam vetëm

Tashmë nuk ka më sy lexuesi në publik që nuk përletet. Dhe bie heshtja sërish. Heshtja është ajo aktorja që rikthehet herë mbas here në skenë dhe ulet në ballë të skenës. As zhurmat kërcëlluese, as këngët e pakënuara nuk dëgjohen më. Shpresa shtrihet pa jetë. E rrëzuar përtokë. Stoli përkundës ku ishte ulur pak më parë, tundet ende.

Skena 7:

Ishte dikur shpresa e mirë që rriste dru, hapte shtigje, ushqente bilbila. Tashmë shpresën e kanë mbytur korbat. Skena mbushet në korba krakëllitës (kurse filmi do të kishte pak atmosferë alla Hitchcock). Korbat plëngprishës që nisin e mburren me zogjtë që i kanë braktisur dhe e mbysin skenën në glasa. Krakëllitjet pushtojnë teatrin, pupla të zeza, kutërbim, publiku del i tmerruar nga salla. Ose nga kinemaja.

Një dramë poetike me intensitet të lartë ndjenjash dhe analogji tematike nga të gjitha kahet.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Unë e lexoj këtë poezi si poezi politike. Është gjëma e gjuhës shqipe. Ja provoje edhe ti ta lexosh kështu, mendoje se “uni”, veta e parë, është gjuha shqipe:

1. *Kërcëllojnë dyert e fqinjëve, kam frikë nga rrethimi, hapa të rëndë që më shkëlin*

– Fqinjët e shqipes e kanë konsideruar historikisht shqipen si kërcënim.

2. *Bota nuk lodhet me mua, mbështetet mbi ditën e nesërme, bëhet mirë dikur*

– Nuk është se çështja e shqipes ka qenë apo është një çështje ndërkombëtare.

3. *Njerëzit e dashur më braktisin, më thonë “mos u mërzit”, “çao!”, ma kthejnë shpinën dhe merren më shumë me shkretëtirën e Gobit se sa me mua. I kërkojnë gurët e rrallë larg prej meje*

– Shqiptarët vetë janë nganjëherë armiqtë më të mëdhenj të gjuhës së vet, kur e mohojnë për gjuhë të tjera, kur e bastardojnë, ia mbyllin grykën e zhvillimit të dialekteve.

4. *Fshehtësia.*

– Ndoshta sepse shqipja ende nuk e ka atë status që dëshiron në Maqedoni. Dhe dëshira e madhe për ta folur. Mallëngjimi për ta pasur.

5. *Këngë e pakënduar*

– Shqipja, kjo këngë që të jehon në zemër, por e mohuar gjatë.

6. *O Shqipëri! Ma jep dorën se jam vetëm*

– Shqipëria, atdheu i shqipes, foleja e ligjshme, o nënë!

7. *Korbat mburrin zogjtë e vet. Krakëllijnë. Kërcëllijnë. Zogjtë e tyre mbushin drurin e shpresës, kurse mua më duhet të mbushem me glasa*

– Kërcënimi real ndaj shqipes. Korbat i vendosin vezët në fole të të tjerëve. Për shqipen mbeten vetëm glasa.

A nuk të duket edhe ty kështu? A të duket se është një poezi politike? Nëse jo, çfarë analogjish të tjera të zgjon? E bukura e interpretimeve të një teksti nga lexuesit është se janë interpretime të hapura, se nuk janë të ndara në interpretime të drejta apo të gabuara, sepse nuk ka një çelës të përgjigjeve ku mund të kontrollohen. Çdo lexues e gjen interpretimin e vet, shtresëzimin e vet. I nisur nga leximi i vet, që është tharmi. Por që të ndodhë një proces i tillë, duhet që poezia të jetë e përjetuar deri në fund

nga vetë poeti. Lexuesi duhet ta ndiejë ngrohjen e brendshme, ta ndiejë se poeti e ka prej vërteti. Sepse nuk zihet kosi me qumësht të ftohtë.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Sa mund të thotë një tekst, pavarësisht kontekstit? A mund ta lexosh një tekst poetik si të pavarur, si të pandikuar, lidhur, varur nga kontekste të tjera. Konteksti i autorit, për shembull, sa ta ndikon leximin?

Është një tjetër poezi e kësaj poeteje, titullohet “Dhoma pa derë dalëse”, që më flakërin në mendje gjithë kohën kur e lexoj këtë poezi. Është sikur ajo të jetë pararendësja e kësaj. Atje rrëfëhet një dhomë nga nuk mund të dalësh. Dhe luhet me raportin midis “dal” si në dalje dhe “ndal” si në ndalim. Dalja është një ndalim. Jeta e unit si një dhomë e rrethuar. Edhe aty ka një shpresë të mirë, një shteg të shpresës së mirë. Dhoma e rrethuar është gjendja permanente, e qëndrueshme dhe e pandryshueshme, nga e cila rrëfëhet gjithçka. A mund t’i iki këtij presupozimi të kësaj poezie në leximin e një poezie tjetër të autores?

Më tej, poetja jeton në Maqedoni. A mund t’i iki unë si lexuese këtij konteksti shoqëror, a nuk jam e ndikuar prej tij kur e lexoj poezinë si poezi politike? A do të mund ta lexoja kështu po të mos e dija këtë fakt?

Kontekstet dhe poetët kanë qenë gjatë aktorët kryesorë në leximet tona, sa na është bërë gjendje ta nisim leximin prej tyre. Dikur ishte çfarë ka dashur të thotë autori, kurse sot është zëvendësuar me çfarë të thotë autori ty? Por gjithmonë autori. Kemi nevojë t’i çlirojmë leximet nga autorët, të ndjekim atë lidhjen magjike që lind midis lexuesit dhe tekstit, direkt, pavarësisht nga poeti. Leximi si tharm. Por asgjë nuk është absolute. Siç po ia provoj vetes me këto përsiatje. Megjithatë, ka disa kontekste që

ta ndjekin leximin. Dhe këtu nuk ka asgjë të keqe. Mjafton të jesh e vetëdijshme se ata janë aty me ty dhe të mos hiqesh se po lexon e pandikuar, e pavarur, kur je e varur edhe ti në drurin e shpresës së mirë.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

O Shqipëri, Shqipëri

Zgjatma dorën

Se jam vetëm!

Leximi i poezisë “Hera-herës” të Mariklena Niços

Hera-herës

Hera-herës

ia beh një krijesë pluhuri e drite

gjithë hir e aromë mëmësie.

Dihat e afrohet.

Ka një pus të thellë në krye

që zbret deri në mitër.

Jehojnë lutje n’shpirt

n’fyt gurgullon heshtje.

Përulet, goja e pusit ndjell humnershëm.

Bie, me ndjesi të panjohura ngjitjeje

ujëra derdhen, dritë shpërthen.

“Sa lehtë më ke lindur, sa heshtur.”

E pyes: “Po dhimbjet?” më thotë:

“Vijnë më pas.”

(“Diafragma e heshtjes”, Botim online:
 Librarium Haemus, 2020)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Duhet ta pohoj se ende pa e mbaruar leximin e parë të kësaj poezie, kam nisur ta rilexoj. Sepse siç ndodh me poezitë që mbështeten në elemente simbolike, në çdo tast që shkel, hapen ikona të reja që të shpien tutje. Kështu e gjej veten duke menduar leximin e dytë pa mbaruar të parin. Dhe leximin e katërt e kam mbaruar me kohë.

Por tashti t'i përmbahem sipërfaqes, fokus!

Hyrja e poezisë është krejt e butë, prej pluhuri e drite, e përbërë nga katër vargje që fryjnë si puhizë, të mbartura jo vetëm nga domethënia e fjalëve, por edhe nga ato *h h h*-të e shumta:

Hera-herës

... beh ... pluhuri ...

... hir ...

Dihat... afrohet

Dhe mandej kjo metaforë e fuqishme e pusit në krye që të projekton një figurë, një imazh, të veçantë në mendje. Dhe njëherësh, ia di kaq për nder poetes që nuk e ka shoqëruar poezinë e vet me një fotografi a pikturë, siç është bërë e modës këto kohë e fundit. Sepse kjo është ndër ato poezitë që e valëvisin si flamur forcën imagjinateve të fjalës. Askush tjetër nuk mund ta përfytyrojë dhe ta figurzojë këtë krijesë që i afrohet poetes, ashtu siç mundet vetë lexuesi. Për mua është një krijesë dadaiste, që në vend të kryetit ka një hinkë me grykë të gjerë me gypin të futur thellë në trup, deri në bark. Te dikush tjetër, ai pusi në krye ndoshta vjen në një formë tjetër. Forca e fjalës është e paparashikueshme.

Prej krijesës emetojnë lutje dhe gurgullima. Dhe kjo figurë përulet. Si dikush që të nderon a sikur të fton në vallëzim. Dhe

poetja bie në një rënie festive derdhjeje dhe dritë. Festive, sepse rënia shoqërohet me një ndjesi ngjitjeje.

goja e pusit ndjell humnershëm

Nuk mund të rri pa e shenjuar këtë varg: goja, pusi, humnera. Kapërthimi i këtyre tri fjalëve, për të nënvizuar ndjelljen e rënies drejt mitrës, ka efekt gati mistik te lexuesi. Një rënie e lumtur, një dorëzim i mbarsur.

Tri vargjet e fundit, mandej, e rrumbullakosin rrëfimin. Filli i mëmësisë së fillimit rikthehet me “si më linde” dhe “po dhimbjet”.

Është shumë e ëndshme në lexim kjo poezi. Kam dëshirë ta lexoj disa herë vetëm për të dëgjuar si më endet nëpër gojë. Ndjellshëm. Dhe puhizshëm. Dhe është një poezi që më mbush me gëzim; dritë shpërthen nga kjo poezi.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Kjo krijesë e butë më afrohet edhe mua. Mundohem ta kuptoj si ia mbërrin poetja të ma projektojë pranë ashtu papritmas, si një hologram nga filmi “Star Trek”. Më duket se janë pikërisht ato hhhhh-të, që sikur ma transportojnë para syve krijesën. Sidomos kombinimi “hera-herës” me “beh” i jep gati një jetë hologramografike. Po kush është ajo? Poezia rrëfen (këndueshëm) se është prej pluhuri e drite, se është gjithë hir e aromë mëmësie, se dihat (nga lodhja, ngjitja?), se ka një pus të thellë në krye që zbret deri në mitër, i jehojnë lutje n’shpirt dhe i gurgullon heshtje n’fyt. Është një krijesë që përshëndet duke u përulur. Dhe flet. Ajo thotë “Sa lehtë më ke lindur, sa heshtur.”. Dhe është ajo që e mbyll poezinë me “Vijnë më pas.”. Mua më vjen si Amësia.

Por ajo që ma veçon këtë poezi, nuk është edhe aq kjo figurë. Në të vërtetë, çka më tërheq edhe më shumë, është ai raporti

intim që poetja krijon midis vetes (dhe si rrjedhim lexuesit që i rri mbas supit) dhe krijesës. Është një raport dashurie, por shkon edhe më tej, është një raport pasioni. Kur i afrohem krijesës dhe e shoh nga afër, vërej se kryet në formë hinke është i gjallë, se pluhuri dhe drita janë në lëvizje marramendëse, ajo hinka është një vorbull. Një vorbull që më thith të tërën në qendrën e saj në mitër. Gëzueshëm. Ajo rënia me ndjesinë e ngjitjes i ngjan efektit të tornados. Një vorbull ndjenjash festive që e thithin poshtë, por edhe e ngrënë lart njëkohësisht. Një rënie e lumtur, një dorëzim i mbarsur.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Amësia është ajo ndjenjë e mrekullueshme që e përfshin gruan qysh në momentin kur në mitrën e saj nis e gurgullon heshtja e krijimit. Por nuk është vetëm kaq. Nuk është vetëm mëmësi. Nuk ka të bëjë vetëm me gruan e mbarsur dhe gruan nënë. Amësia është ndjenja që buron nga ama. Dhe ama është vezorja e gruas, por është edhe vendi ku nis një rrjedhë uji, është edhe gurra, është edhe druri që mban çatinë, është ndjenja që na mban në amë, në udhën e drejtë. Është ndjenja që na fisnikëron, na fton të kujdesemi për jetën në të gjitha format e saj, na i jep kuptim jetës. Dhe kjo pavarësisht në jemi burra a gra, në jemi prind a jo. Është një ndjesi që ia beh herë mbas here te të gjithë ne dhe na pastron prej ligësisë dhe fanatizmit.

Na mëson të lëshohemi në vorbullën e purifikimit për të parë vlerën e vërtetë të jetës, për të parë amën.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Po dhimbjet?

Ato vijnë më pas.

Leximi i poezisë “Homo Migrantis” të Shqiptar Osekut

Homo Migrantis

Më ndalonin në çdo kufi

Më kujtohet

Ma kërkonin një letërnjoftim të vjetër

Unë ua jipja e ndrydhja panikun

Aty më rrinte emri mbiemri

Data e vendi i lindjes

Ishte mot i lig

Mua më ndiqnin të shtëna

E ata lexonin me belbëzime

Qenien time

Ma skanonin dyshueshëm

Dikur më lejonin të dal

(Por jo të hyj-

kejo do të më mirrte akoma tjera vite)

Tashti në kufi ndalin kipcin tim

*Të ndjekur me të shtëna
Ia skanojnë
shkaqet e qenies
Belbëzimthi
Emrin, mbiemrin, datat e vendet
(Thua se dikush bëhet unë pa arsye)
E ai mban erë gjak-
Unë ndiej në eshtra tek vjen
Një mot i lig
E kërkuj me instinkt në xhepa
Letërnjoftimin e vjetër*

(“Enciklopedia e Mërgimit”, Tiranë, 2019)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

HOMO MIGRANTIS, titulli i bie gozhdës drejt e në krye. Për lexuesin që e ka gozhdën të matur në mish të vet, dhimbja është gati fizike. Në poezinë shqiptare, ku ka disa vite që po përpiqet të rrëfejë emigrimin, ikjen, syrgjynosjen, hyn më në fund një term që e përfshin të gjithë fenomenin: homo migrantis, një metaforë etnografike. Gjetja e këtij përcaktimi është kapësja e parë që e shtrëngon poezinë dhe e ngre atë nga masa gri e poezive të rëndomta të emigrimit. Homo Migrantis i rrëfyer këtu si një specie më vete, që mbahet fort mbas një karte, vlera e së cilës bëhet e pazëvendësueshme, pikërisht kur je një homo migrantis: letërnjoftimi, karta që të përcakton aty ku askush nuk e di (dhe as do t'ia dijë) se kush je. Karta që ta përcakton dhe ta përkufizon fatin. Letërnjoftimi si metaforë dhe si mallkim. I mbushur me emra të vështirë (a të frikshëm), që askush nuk mund t'i shqiptojë, veç t'i belbëzojë.

Poezia është e ndërtuar në dy rrafshë kohore, dje dhe sot, të ndara dukshëm.

Pjesa e parë e poezisë është rrëfimi i së djeshmes, “më kujtohet”, dhe koha e pakryer e foljeve mbështesin rrëfimin e ikjes. Një ikanak që ikën me panikun dhe letërnjoftimin si të vetmit shoqërues. Të dy këta shoqërues janë prova të një identiteti të refuzuar, një identitet që veç belbëzohet, skanohet dhe askush nuk e pranon krahëhapur. Një ikje, për më tepër, e përsëritur në kohë “Dikur më lejonin të dal/(Por jo të hyj - kjo do të më mirrte akoma tjera vite)”.

Pjesa e dytë e poezisë është kthim në të sotmen të shënuar me “tashti” dhe foljet në të tashmen. Një kipc shfaqet në skenë. Një kipc, një dytëshor, thotë Fjalori, “njeri që nga pamja e jashtme duket pothuajse njësoj me një tjetër, njeri që i ngjet aq shumë një tjetri, sa mund ta marrim për të, kipc”. Ja, e mësova edhe një fjalë

që nuk e dija, më ndodh rëndom kur lexoj Osekun. Në pjesën e dytë të poezisë, rrëfimi i ikanakut i përket një tjetri. Poeti veç sa ia ndien erën ikjes, vjen era gjak dhe historia përsëritet. Poeti ndihet si kipci: poeti dje, kipci sot. Poeti është kipci, kipci është poeti. Poezia mbyllet aty ku nisi, në panikun e ndalimit në kufi. Në çdo kufi. Duke e mbyllur kështu rrethin e identifikimit.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

A e lexove edhe një herë?

Teknikisht *Homo Migrantis* është poezia e mjeshtërisë së identifikimit tredimensional. Në sipërfaqe të duket se shenjat më të rëndësishme janë ato që shenjojnë kohën, udhëtimin në kohë të poetit, historinë që përsëritet. Lexuesi rri në majën e kodrës së leximit të parë dhe kundron ç'u bë. Aty poshtë, *Homo Migrantis* shalon fatin e vet, në këtë rast i ndjekur nga të shtëna. Por s'është veçse sipërfaqja. Ajo që vlon brenda leximit është edhe një tekst tjetër: është përsëritja këmbëngulëse dhe e pamëshirshme e përemrave që shenjojnë vetën e parë:

Më ndalonin...

Më kujtohet...

Ma kërkonin...

Unë...

më rrinte...

Mua më...

Qenien time...

Ma skanonin...

më lejonin...

do të më mirrte...

Toka nis të tundet e shkundet në leximin e dytë. A e ndien? Ajo që lexuesit së pari iu duk një kodër vrojtuese, në të vërtetë është kurrizi i një kafshe të madhe. Kafsha çohet ngadalë në këmbë dhe nis lëviz me lexuesin kaluar. Paniku i ikjes, skanimi i genies, të shtënat, bëhen pjesë e përjetimit të vetë lexuesit, që në këtë mënyrë e kalon kufirin e poetit. Ndjekja, përndjekja bëhen pjesë e përjetimit të leximit. Angështia e poetit bëhet angështia e lexuesit. E kaluara e poetit përjetohet *live* nga lexuesi: ndjekja, ndalimi, dalja, moshyrja.

Deri këtu, gjithçka është e njohur, si teknikë dua të them. Rrëfimi në vetë të parë e krijon shpesh iluzionin e identifikimit me poetin. Kjo këmbëngulja kryefortë me përemra identifikues e shënon një talent të veçantë, por origjinalja e kësaj poezie është megjithatë se ajo e shtyn edhe më tej lexuesin. E shtyn në pjesën e dytë. Aty ka edhe një kufi tjetër që duhet të kalohet: kufiri i kipcit. Poeti nuk po rrëfëhet për të treguar historinë e vet. Përndryshe do të ishte një poet i zakonshëm dhe këto lexime nuk do të shkruheshin kurrë. Sepse historia e poetit është shkruar edhe herë të tjera në mënyra të ndryshme. Por në pjesën e dytë të Homo Migrantis, vetë poeti e kalëron fatin e kipcit, identifikimi me të shprehet qartë:

Thua se dikush bëhet unë pa arsye

Kështu hapet loja e identifikimit: lexuesi, poeti dhe kipci: Lexuesi është poeti, poeti është kipci, kipci është lexuesi? Kjo është mjeshtëria. Mbyllja e rrethit i jep një karakter gati universal poezisë. Të gjithë e ndiejnë motin e lig që po afrohet, të gjithë njëherësh kërkojnë në panik nëpër xhepa letërnjoftimin e vjetër. I ndalur në çdo kufi të poezisë, lexuesi letërnjoftohet me përjetimin e poetit.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Dy mendime më përsillen në krye duke lexuar:

- Ku ka Homo Sapiens do të ketë Homo Migrantis.

- Një herë Homo Migrantis, gjithmonë Homo Migrantis.

Ai çfarë je ti sot, do të jetë dikush tjetër nesër. Të gjithëve na përndjekin të shtënat, në mos sot, nesër. Jemi të gjithë ikanakë dhe kalërojmë të njëjtin fat. Era e gjakut ndihet sot në gjithë botën. Vrojtuesit janë kalërues, me dashje apo pa dashje. Ikanakët e djeshëm janë vrojtuesit e sotëm. Ku ka Homo Sapiens do të ketë Homo Migrantis. Një herë Homo Migrantis, gjithmonë Homo Migrantis. Poezitë e mira kanë të ndërtuar në vetvete një aktualitet që nuk vjetrohët kurrë. Dhe në u pastë vjetruar, e kanë aftësinë të ta projektojnë si të gjallë në ndjesitë e tua.

Poezia është interesante edhe në një plan tjetër, në planin e poetikës së mërgimit. Poezia e mërguar shqiptare ka zakonisht dy qasje ndaj gjendjes së vet: patriotizëm dhe mall. Patriotizmi është karakteristik i një mërgimi politik. Malli është karakteristik për poezinë e sotme të mërgimit ekonomik. Homo Migrantis i përket një poezie globale të mërgimit. Një poezi që është gjithnjë në kërkim të identitetit. Kjo poezi, çdo kufi e përjeton si etapë të zhvillimit të një identiteti të ri.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Unë qëndroj në kufi. Më ndalonin në çdo kufi. Sytë dyshues të policit të kufirit ma skanojnë qenien. Unë dhe letërnjoftimi bëhemi një. Unë jam shqiptare. Viza i duket false. Unë jam fals. Më kthen në kufi. Unë qaj. Gozhda rreh në mish.

Je suis, Homo Migrantis.

Leximi i poezisë “Identitet” të Ilire Zajmit

Identitet

*Kam kartë identiteti me gabim shtypi
 Pasaportë të udhëtoj në pak vende të botës
 Vendlindja ime ka dy emra
 Më thonë shqiptar etnik në një shoqëri multietnike
 Qeverisem nga një bandë horrash e politikë injorante
 Marr pagë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës
 Kam të hapur llogari bankare në një bankë amerikane
 Babai im merr 70 euro pension
 Nëna ime arsimtare më shumë bën grevë sesa punon
 Motra ime ra në dashuri me një irlandez
 Vëllai im proteston për një universitet ndryshe
 Fqinjët e mi shpresojnë se djali i tyre është ‘dek’ a gjallë diku në Serbi
 Anna Ahmatova, më thuaj si ta deshifroj identitetin
 Unë jetoj në qytetin gjysmëmilionësh
 Në Kosovën që e zhgënjeu ëndrra e pavarësisë
 Pi espresso të lira me miqtë e mi
 Shkruaj sms e bëj dashuri virtuale*

Jetoj në vendin me status të padefinuar politik

Ku dikush thotë se ka pasur luftë

E ca të tjerë thonë se ishte vetëm konflikt

(“Një luftë e pakryer”, Prishtinë, 2020)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Rastësisht më ndodh ta kem në dorë këtë poezi, njëkohësisht që telefoni im po bie copë nga lajmërimet e një diskutimi ku jam përfshirë në *Facebook*, në një nga ato grupet që ne mërgimtarëve na zëvendësojnë kafenenë e mëmëdheut, ku shkrimtarët mbledhen për të diskutuar. Njëri nga ne pyet grupin “Çfarë e bën të mirë një poezi për ty?” dhe përgjigjet vlojnë. Janë të gjithë emra me penë të mprehtë. Brenda një ore, ka përkufizime nga më të mirat, të tilla që më vjen keq që grupi nuk e ka një sekretar për t’i mbledhë e botuar diku. Kriteri, ngulmon kryeneçi që shtroi pyetjen, cili është kriteri? A ka një kriter objektiv? Apo të gjitha kriteret janë subjektive?

Çfarë është një poezi e mirë? Kjo më rikthen te një pyetje më e vjetër se unë, çfarë është poezia? A është poezi kjo që po lexoj? Po të mos ishte e thyer në vargje, a do të ishte përsëri poezi? Çfarë është gjuha poetike? A ekziston poezia pa figura letrare? Çfarë janë figurat letrare?

Dhe mandej, pse vallë më pëlqen aq sa ta plotësojë menjëherë kriterin tim të përhershëm të shtysës për ta rilexuar?

Ky lexim e di se do të jetë që në fillim një diskutim më i madh se kjo poezi. Takimi me poezinë është gjithnjë i tillë. Nuk ka rëndësi kush e ka shkruar dhe përse dhe si, takimi me poezinë varet në kush është lexuesi, në kontekstin në të cilin ndodhet. Tashti fati i kësaj poezie ishte të vinte tek unë, në mes të një diskutimi mbi poezinë. A thua do ta lexoja ndryshe po të isha e ulur në një lëndinë në pranverë, me kryet e mbështetur në supin e të dashtunit? Ndoshta.

Vargjet e bëjnë poezinë, ky është një kriter i padyshimtë. Forma dërgon sinjale të qarta. Proza mund të jetë poetike, në kuptimin që na përmbush pritshmëritë poetike të poezisë, për shembull, por nuk është poezi. Nga ana tjetër, një poezi mund të

na përmbushë pritshmëri prozaike të prozës, por nuk është prozë, sepse është e shkruar në vargje. Duke e shtyrë arsyetimin më tej, një vepër e shkruar në shqip, edhe pse trajton tema të Italisë, është megjithatë letërsi shqiptare. Ashtu si një vepër e shkruar në italisht, edhe pse trajton tema të Shqipërisë, është letërsi italiane.

Edhe gjuha poetike është një kriter. Poetike në kuptimin “e veçantë, e përzgjedhur”, apo gjuha poetike në kuptimin gjuha faktike e poezisë? A e lidhim shprehjen “gjuhë poetike” me pritshmëri të përzgjedhura, që vetëm të përzgjedhurit e poezisë mund t’i trajtojnë? Edhe këtu ka qëndrime të ndryshme: Në njërin ekstrem, qëndrojnë ata që e konsiderojnë poezinë diçka që dukshëm (d.m.th. jo vetëm për hir të vargjeve) duhet të dallojë nga diskursi i përditshëm, përndryshe ç’u pa puna? Ku është poezia nëse fjalët që e përbëjnë janë fjalët e së përditshmes? Ku është poezia nëse nuk të bie të fikët në gjysmë të vargut? A mos është art banania me letër ngjitëse në mur?

Në ekstremin tjetër qëndrojnë ata që mendojnë se poezinë e bën përjetimi i lexuesit. Se nuk ka rëndësi nëse poeti përdor diskurs të përditshëm, apo fjalë të përzgjedhura në kushedi cilin fjalor të mykur poetik. Rëndësi ka emocioni, përjetimi, përthellimi, përthekimi që ndodh te lexuesi. Marrja e bananes nga tezga e tregut dhe ngjitja në mur para syve të kundruesit si një akt artistik. Unë u përkas të dytëve, pa dyshim, edhe pse jo në ekstrem.

Të dyja palët e poezive, si të përzgjedhurat, si të thjeshtat, mund ta lënë lexuesin pa asnjë emocion. Lexon poezi me fjalë të përzgjedhura zgjedhë mbas zgjedhe, që vetëm ta lidhin një përjetimin. Lexon mandej poezi me fjalë të mbledhura në radhën e djathit dhe të kap gazi. Por hajt, më mirë që shkruajnë poezi se të kacafyten me ata që hyjnë pa radhë. Por nga ana tjetër, edhe poezia e mirë mundet t’i japë emocione një lexuesi, por jo një tjetri. Atëherë çfarë?

Lexoje tashti, të lutem, edhe një herë këtë poezi!

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Ti me siguri e ke vënë re se kjo është ndër ato poezitë që luan në planin e përditshmërisë. Fjalori është marrë nga një diskurs aspak poetik, në kuptimin që i japin kësaj fjale ata të grupit të parë të sipërpërmendur. Për shembull *pagë, llogari bankare, espresso, sms*. Ku është poezia këtu? Ma merr mendja se mbrojtësit e poezisë “së vërtetë” janë mbyllur qysh tash në qoshe të mbrojtura. Për më tepër, ritmi nuk është poetik. Thyerja e vargjeve, për shembull, i ngjan një liste të një pamfleti të hartuar në nxitim e sipër. Ku është ajo thyerja e papritur e vargut që të lë pa frymë, apo thyerja ritmike që të lë pa fjalë?

Por në leximin e dytë duhet ta kesh vënë re se kjo platforma e rrafshët e përditshmërisë është si dhogë e vendosur mbi një cilindër. Lexuesi qëndron mbi të si adoleshentët që luajnë lojën e drejtpeshimit. Hapi krahët dhe mbahu vetë se fjalët nuk kanë me të mbajtur; disa janë dhoga e disa janë cilindër. Më ndiq tashti:

– Karta e identitetit është dërrasë e rrafshët kuptimisht, ajo tregon kush jemi, si quhemi, ku dhe kur kemi lindur. Tani mendoje me gabime shtypi. Ajo kartë që tregon kush jam, mban gabime shtypi që shkojnë drejt e në qenien time. Nëse unë jam ajo që shkruhet, atëherë unë jam gabimi i shtypit. Pra, karta është dhoga dhe gabimet cilindri. A e ndien si po përpiqesh të mbash drejtpeshimin, që të mos biesh?

– Pasaporta, dokumenti që të lejon të dalësh jashtë shtetit. Vendose tashti mbi cilindrin e kufizimeve në udhëtim në pak vende të botës.

Me siguri, e sheh qartë lojën e paradokseve, e mbajtur gjithmonë në një nivel të kujdesshëm balancimi. Mua më pëlqen shumë ky varg:

Fqinjët e mi shpresojnë se djali i tyre është ‘dek’ a gjallë diku në Serbi

sepse është ndër ato strukturat dyshe, dhogë mbi cilindër mbi dhogë mbi cilindër, që vetëm akrobatët e zotë i provojnë. Së pari, kemi “fqinjët” (dhoga) që përcaktojnë një entitet shumë të afërt në hapësirë përkundrejt “diku në Serbi” (cilindri), një vend tjetër në hapësirë. Krahasoje, për shembull, po të ishte “miqtë e mi shpresojnë se djali i tyre është ‘dek’ a gjallë diku në Serbi”. Pamundësia në hapësirë ia shton intensitetin lëkundjes në cilindër. Në qendër të vargut “shpresojnë se djali i tyre është ‘dek’ a gjallë”, shkund emocionalisht një tjetër strukturë cilindrore: nga njëra anë “shpresojnë” (dhoga) e vendosur mbi një dallgë cilindrore “se djali i tyre është ‘dek’ a gjallë”. Ajo që fqinjët druajnë, është se djali u është zhdukur pa nam e nishan. Ata nuk shpresojnë se është gjallë, që do të ishte një dhogë kuptimisht e qëndrueshme, e dhimbshme, por e qëndrueshme. Por ata shpresojnë që ai është diku, dek a gjallë. Ngarkesën emocionale të këtij vargu nuk mund ta balancojë asgjë.

Një tjetër varg interesant nga perspektiva e teknikës është:

Anna Ahmatova, më thuaj si ta deshifroj identitetin

Poetja ruse Anna Ahmatova, e thirrur si dëshmitare në këtë kontekst është cilindri mbi të cilin poetja vendos dhogën e identiteti. Pse cilindër Anna Ahmatova? Sepse ajo është një poete që mban në vetvete shumë paradokse. Për shembull, është poetja që i rezistoi me poezinë e saj zhbërjes komuniste, por është edhe ajo që botoi lavde për Stalinin. Është poetja që, edhe pse u censurua dhe iu “mbyll goja” nga regjimi, nuk pranoi të ikte nga viset ku flitej gjuha e poezisë së saj, zjarri dhe uji. Këto janë asosacionet që më zgjon mua, por me siguri ty të jep asosacione të tjera, ndoshta vargje nga poezia e saj apo nga jeta private.

Teknika e kësaj poezie i ngjan, pra, një loje ekuilibruese që ia tund tokën nën këmbë lexuesit.

Për mua është loja, loja e fjalëve, e kuptimeve, e emocioneve, e

ritmeve, e ngjyrimëve, loja estetike, një karakteristikë qenësore e poezisë së mirë. Është kjo që e bën poezi, për dallim nga diskursi i së përditshmes. Se banania nuk ka nevojë me qenë e pikturuar si natyrë e qetë që të konsiderohet art. Ashtu siç jo çdo banane në treg është art. Dhe këtë lojë të teknikës, di ta luajë vetëm talenti.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Ana e fortë e poezive të angazhuara politikisht është se e shtyjnë lexuesin të zgjedhë anë, të revoltohet, të mbajë qëndrim, të ballafaqohet me realitetin. Ia shkund puplat e ngrohta dhe e lë lakuriq me atë që po i ndodh përreth. Poezia në këtë mënyrë shndërrohet në një pincë që ia kthen kryet lexuesit andej nga do vetë. Prandaj, kjo lloj poezie kërkon poetë me “duar” të fuqishme që i qëndrojnë përpjekjes që lexuesi bën instinktivisht për t’u çliruar nga shtrengimi. Ç’po ndodh kështu me ne shqiptarët? Ndërtojmë shtete që nuk janë shtete, me administratë jofunksionale (gabim shtypi), korrupsion (bandë horrash), varfëri (70 euro pension), ekonomi jo e qëndrueshme, papunësi, krime që nuk ndëshkohen, të rinj që mezi presin të ikin jashtë me dashuri a pa dashuri, sistem arsimor që nuk ia ke besën etj. Zhgënjimi e mban poezinë në grusht. Pjesa e parë është gati indiferente në transmetimin e këtij zhgënjimi. Siç jemi zakonisht të gjithë ne. E kalojmë ditën duke bërë listën e sendeve që nuk shkojnë. Si Kosova e zhgënjyer që pi *espresso* të lira me miqtë, kafe, llafe.

Por në tri vargjet e fundit, lista ia lë vendin shpalljes:

Jetoj në vendin me status të padefinuar politik

Ku dikush thotë se ka pasur luftë

E ca të tjerë thonë se ishte vetëm konflikt

Kjo, i dashtun lexues, është tragjedia më e madhe e popullit

tonë. Mosnjohja, harresa, mohimi i historisë. Mosmësimi nga ajo çfarë ka ndodhur. Këtu jam unë, thotë poetja, në një vend që nuk e njih si shtet gjysma e botës dhe ti më diskuton ende në ishte luftë a konflikt?!

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Baaah! Asgja nuk m'i çon nervat më shumë se pasiviteti i popullit tem. Rend, rend e u thuej, se nuk u shtur hordhi e huej.

Leximi i poezisë “Ke thithur ndonjëherë një dorëzonjë?” të Rudina Çupit

Ke thithur ndonjëherë një dorëzonjë?

*A e ke futur hundën në lugun e ngushtë
për t'ia thithur krejt erën sa të mbetesh pa frymë,
të ngopësh mushkëritë e të ndiesh se po dehesh?*

*A e ke futur në gojë rrëzën e petalit
për t'ia thithur krejt ëmbëlinë, për ta ruajtur në kujtesë
atë shije njomështie e të është dukur se më s'do ta gjesh?*

*A i ke mbyllur sytë fill pas kësaj
e të ka marrë malli për një puthje,
të dorëzohesh me dikë që as fytyrën nuk ia njeh?*

*Humbu nëpër botë e më gjej,
shijen e dorëzonjës mbaje si hartë:
thirrja e dashurisë dhe unë të pres.*

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

A e lexove? Ruaje tashti në vete ndjesinë e parë që të krijoi, sepse ndjesia ime e parë është krejt tjetër dhe dua të mos ndikojë te jotja.

Leximi im i parë është një lexim që kolovitet ndjenjash të habitshme dhe zemërimit. Papritmas, jam e revoltuar. Sytë më nxihen dhe nuk arrij të lexoj e qetë. A e kupton pse? Ja, po të jap një rresht bosh që të kesh kohë ta glesh.

Sepse më duket sikur e kam shkruar unë: “a e ke provu me e zhytë dorën në flakë”, “a e ke provu me e gërmu me gishta/dheun e ngurtë në pranverë”, “e ke harru çfarë asht mjedra/ ai fruti i butë që t’i jepet gishtave/ lëpimje e ngjyeme në gjak?”, “a mundet me të marrë malli për atë që s’e njeh?”, “a e nuhat me hundën teme?” Dhe zgjidhja në fund. A nuk është kjo teknika ime? A nuk është kjo tipike e poezisë sime? Në pak minuta, i kam kaluar me mend të gjitha poezitë e mia që i ngjasojnë kësaj, me pyetje direkte “a?”. Në pak minuta, më mbledhen të gjitha hidhërimet e leximeve të sendeve të mia në poezitë e të tjerëve, kopjime haptas a pa vetëdije, fryhem dhe fryhem në revoltë. Fryj dhe fryj. Bah! Kulmi! Derisa shpërthej. Në gaz.

Ideja e madhështisë së poetit është një fenomen interesant, një dukuri psikologjike, që duhet studiuar një ditë. Ideja se je e veçantë, e paarritshme, se të gjithë e kanë ose do të duhej t’i kishin mendjen dhe zemrat te ti, se pa ty bota rrotullohet kot, se ti i jep kuptim ekzistencës së poezisë në jetën e njerëzve. Po. Poeti është narcis si definicion. Unë jam patjetër kaq e mrekullueshme prandaj hipoteza fillestare duhet të jetë: si mund të mos duan të më kopjojnë, si mund të mos ndikohen prej poezisë sime, patjetër u ka hyrë në palcë. Ha ha ha! Kisha kohë pa qeshur me

veten kështu. Hulumtuesja në mua ia nis menjëherë punës për të m'i hedhur poshtë pandehmat:

– Mos i shpikë gjë ti, pyetjet direkte në poezi? Kushedi sa poezi të tjera kjo poete ka shkruar në këtë formë! Ndoshta kjo është teknika e saj.

– Përjetimet shqisore si abstragime poetike, mos i shpikë ti? Ndoshta ti nuk je e vetmja poete që i nis poezitë me ndijime gishtash, hundësh, sysh, goje, fyti, lëkure. Kushedi, kështu shkruan gjithmonë kjo poete.

– Sendet e thjeshta në poezi, mos i shpikë ti? Kushedi, ndoshta kjo është e veçanta edhe e kësaj poeteje, ajo shkruan për sende të thjeshta.

– Zgjidhjen e poezisë në fund, mos e shpikë ti? Ti nuk di asgjë për këtë poete, e dashur. E kërkove sot në internet vetëm se lexove fjalë lavdërimi në një gazetë dhe u bërë kurioze. Sa keq që nuk mundkam t'ia porosis librat në internet, por sapo ta gjej do të ulem që t'ia hedh poshtë vetes hipotezat një e nga një.

Ekziston një mundësi shumë konkrete se ajo nuk të ka lexuar kurrë, se ti edhe ajo veçse jeni poete të të njëjtit brez, me të njëjtin formim estetik dhe ndjeshmëri poetike.

E qeshura të zgjat jetën dhe të kthen humorin, ti e di. E qeshura me veten për veten është mandej argëtim me vete. Shumë freskues. Dhe tashti më në fund mund ta lexoj poezinë, siç lexohet. Jo si poete narcize, por si lexuese narcize, që mendon se leximi është i vetmi që ia vlen.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Ose përsiatje mbi pyetjen direkte në poezi.

A e di cila është magjia e pyetjes direkte në poezi? Sepse nënkupton një lexues. Poezia është si definicion një “dërdëllitje” e poetit me vete. Kurse pyetja, sidomos ajo e drejtpërdrejta në

vetë të dytë, e thyen këtë monotoni. E kap lexuesin nga gryka dhe e fut zhurmshëm në poezi. E detyron të ndiejë bashkë me poeten, atë që do poetja, kur dhe si do ajo.

Ja, ta vërejmë bashkë ndryshimin. Poezia mund të ishte, për shembull, *në urdhërore*:

Fute hundën në lugun e ngushtë

thithja krejt erën sa të mbetesh pa frymë,

ngopi mushkëritë e ndiej si debesh!

Edhe kjo është një formë shumë aktive, por këtu vullneti i poetes bëhet i gjithëfuqishëm në një mënyrë tjetër. Lexuesi veçse ndihet i detyruar t'i nënshtrohet veprimt të foljes. E shkruar nga një poet që e kemi për zemër, do të ishte një formë efektive. Sepse kur e shkruan dikush që e adhurojmë, i "nënshtrohem" me kënaqësi. Madje një pjesë e kënaqësisë mund të ishte pikërisht nënshttrimi, përndijimi i nënshtroar i kënaqësisë. Poeti i panjohur e ka më të vështirë. Reagimi spontan i lexuesit është mosbesimi. Dhe një reagim mosbesues ndaj poezisë është shenjë e dështimit të kësaj të fundit. Urdhërorja funksionon nganjëherë si ndërrim i papritur i gjendjes, si thyerje e përsiatje vetmëveti, se ia kujton lexuesit rolin e vet të vërtetë, pikërisht atëherë kur nuk e ka mendjen. Pikërisht siç bën poetja në strofën e fundit.

Poezia mund të ishte edhe në vetë të parë, rrëfim i përjetimit të poetes:

E fus hundën në lugun e ngushtë

për t'ia thithur krejt erën sa mbetem pa frymë,

mushkëritë më ngopen dhe ndiej se po debem.

Edhe kjo është formë e mirë, e përdorur tradicionalisht nga të

gjithë poetët. Është mënyra e poetit për të folur me veten. Leximi atëherë mbështetet në aftësitë identifikuese të poetit me lexuesin dhe anasjelltas. Kjo është edhe forma që e dallon më qartë nga të gjitha format e tjera poezinë e dobët nga poezia e mirë. Poezia e dobët nuk të thotë gjë, nuk të emocionon, nuk të prek, nuk të ndryshon asgjë, është një kalimtar që të kalon përbri, më së shumti ia vëren pak rrobat, por edhe ato do t'i harrosh sa hap e mbyll sytë, d.m.th., sapo ta kesh mbaruar së lexuari, sepse rroba të bukura mund të gjejë gjithkush. Kurse poezia e mirë është ai kalimtari që të vjen përballë dhe ti nis ia ndien praninë që në vështrimin e parë, që mezi pret të të afrohet t'ia ndiesh aromën, që i flet ti e para vetëm për t'ia dëgjuar zërin, që bën gjoja se mërdhet vetëm që të ta zgjasë pallton e ngrohtë, e cila të bëhet lëkurë në momentin që i ke futur krahët në të.

Por pyetja në poezi është ndryshe. Ja, lexoje edhe një herë:

A e ke futur hundën në lugun e ngushtë

për t'ia thithur krejt erën sa të mbetesh pa frymë,

të ngopësh mushkëritë e të ndiesh se po dehesh?

Këtu poetja të fton të ndiesh me të. Metafora e hundës në lug, për shembull, të transporton në një dimension erotik, që nuk është vetëm i saj, por edhe yti. Ajo është sufleri, por përndijimi është yti. Dhe mbas leximit, të mbetet ndjesia e një leximi që pat kuptim edhe për ty. Sepse erdhi nga ti. Sepse pyetjen e bëri ajo, por përgjigjen e ke ti.

Leximi i tretë (ose leximi i mendimit)

A e njeh lulen e dorëzonjës? “Shkurre kacavarëse me gjethe gati rrotullare, që çel lule të kuqërreme nga jashtë e të verdha nga brenda, të cilat i ngjajnë një dore të vogël me gishtërinj

të përkulur dhe kanë erë shumë të mirë”, thotë Fjalori. *Caprifoglio, honeysuckle*. Në Shkodër, i themi “lulemustak”, ose “luledurham”, sepse thuhej se i pëlqente shumë Lady Durhamit, legjendë ndoshta. Takimi me këtë lule është gjithmonë një përvojë më vete. Është e vështirë t’i kalosh afër indiferente: ngjyrat, forma, ajo çmenduria kaçurrele që i përmbyt muret dhe të fton, ashtu si poetja, të zhytësh hundën dhe të mos harrosh. Por poetja do më tepër, ajo të fton ta shijosh. Ne, fëmijët e brezit tim, të rritur me mungesën e çokollatave dhe karamelave, i kemi provuar në gojë të gjitha lulet, të etur për të ngrënë diçka ëmbël, diçka përpos bukës të përditshme me margarinë (në rastin më të mirë). Ne ia dimë shijen lulevile, trëndafil, kokrrave dimërore të trëndafil, gjetheve të shebojave. Dhe shija e dorëzonjës, e mustakut, është me të vërtetë si puthja e përkruar nga poetja, një puthje e magjishme me të panjohurën. Është një metaforë e bukur, që më transporton në kohë, e mbartur tundueshëm, tamam siç i mban petalet kjo lule.

Këtë pranverë, mos e lër pa e provuar një lulemustak!

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Vallë mos po shkruajmë të gjithë të njëjtën poezi? Sa unike është poezia, a mos jemi të gjithë tela të të njëjtit instrument? Kur instrumentin mund ta mbërrinin vetëm disa, atëherë dukej sikur këta ishin unikë. Por ndoshta nuk ishin. Ndoshta ishin unikë, sepse ishin të paktë kalimtarët që kalonin në rrugë, sepse ishin të pakët që e dinin rrugën. Por tashti rruga është plot me kalimtarë, për fat. Ndoshta njeriu është poet në parim, por poezia aktivohet vetëm në disa prej nesh, kushtëzuar nga faktorë shoqërorë. Po çfarë na dallon sot, kur uniciteti nuk qëndron më në kalimin nëpër rrugë?

Ndoshta është palltoja. Ajo palltoja e ngrohtë njerëzore, që të josh t'ia fusësh duart e tua në mëngë dhe të të bëhet lëkurë. Edhe në qoftë e prodhuar në seri, apo ekskluzive e markës, nuk ka rëndësi. Sepse ndoshta nuk është më poezia ajo që është unike. Është përjetimi i lexuesit që e bën unike poezinë e sotme.

Leximi i poezisë “Korba unë!” të Eli Krasniqit

Korba unë

Jam ba e keqe, i dashun

Korbat më rrijnë në parmakun e dritares teme

Me fytyrë kah unë, më mbrojnë prej “njerëzve të mirë”

Jam ba krejt vner, shpirt

Korbat ma hanë çdo ditë nga pak fisnikinë teme

Dhembja të ban shpirtvogël nganjëherë

Jam ba krejt helm, dielli jem

Korbat kërcejnë në kuzhinë shkelin bukën që e ha

I lajnë gjurmët në gjalpë e mjaltë

Jam ba fjalëkeqe, frymarrja jeme

Korbat m'i marrin fjalët e bukura

*Butësinë ma ndryjnë me shtatë dryna
në shtatë ditë të javës*

*Jam ba e padurueshme, drita jeme
 Korbat ma nxjerrin mllefin për gjana të vdekshme
 Zanin që m' asht shtypë me shekuj errësie*

*Jam ba ditëvogël, jeta jeme
 Korbat ma nxjerrin frikën e lëndimit
 Nuk më lanë pa të me jetu*

*Jam ba harrestare, heshtja jeme
 Korbat ma shlyjnë kujtesën
 I lanë vetëm gjanat e këqija mëngjeseve mbijetu*

*Kam mbetë pa kangë, tingulli i jem
 Korbat më krrokasin muzgjeve
 M'i mbyllin veshët me krimba të mbledhun nëpër degë*

*Kam mbetë pa miqtë e mi të ngushtë, verbnia jeme
 Korbat i pengojnë me flatra kah unë me ardhë
 I zmadhojnë fajet e vockla prej njeriu, kërkim faljen teme në fyt ma lanë*

*Kam mbetë pa ty, andrra jeme
Korbat më hanë mue
Të lanat e fundit prej meje që dashunia jonë i la*

*Korba unë, dashunia jeme
Honit po lëshohem ngadalë
Pavërejtshëm me u shu.*

(Facebook, 2016)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Poezia e dashurisë së humbur është një poezi që nuk resht kurrë së shkruari. Por kjo nuk është një poezi e këngës së humbjes. Rrëfimi i kësaj poezie është brutal. Dhimbja nuk romantizohet, as nuk merret me të mirë. Madje nuk e ka as luksin e pikëllimit. Dhimbja është veçse një prani e vërtetë, e mbushur me mllef, shkatërruese dhe vetëshkatërruese.

Skena është e thjeshtë: një dritare nga ku kundrojnë disa korba, një tavolinë kuzhine me gjalpë dhe mjaltë përmbi dhe një grua që ndoshta po ha mëngjesin. Dhe dhimbja, kjo dhimbje e pamëshirshme që e gërryen gruan me sqepin e korbit. Dhimbja ha veten për mëngjes. Gërryen, gërryen derisa nga gruaja nuk mbetet asgjë, as kërma. Derisa gruaja vetëshndërrohet në korbin e dhimbjes së personifikuar nga kuja “korba unë!”. Poezia mbahet pikërisht për këtë lojë fjalësh mes korbave dhe thirrjes “korba unë!”, që ia shton dramaticitetin, me tingëllimin “krau”, që e shkreton krejt dhe në strofën e fundit parashikon shndërrimin, humbjen më të madhe mes humbjeve, humbjen e njerëzores nga dhimbja. Honi më i thellë nuk është honi i humbjes së dashurisë, por është pikërisht honi i humbjes së vetvetes, i humbjes së kuptimit të jetës.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Poezia të kujton teknikisht lojën në piano. Dora e djathtë luan melodinë e dhimbjes. Melodia është therëse, me nota të mprehta, të vetmueme, stakato, secila me peshën e vet që shkojnë duke grumbulluar njëra-tjetrën në një pentagram që pret shkretimin e “Korba unë!”:

Jam ba e keqe

vner

helm

fjalëkeqe

e padurushme

ditëvogël

harrestare

Kam mbetë pa kangë

pa miqt e mij t'ngushtë

pa ty

Dora e majtë luan akordet e korbave. Tonet janë të rënda, gjithmonë e më kërcënuese. Korbat në fillim janë larg dhe veç kundrojnë, por mandej nisin e afrohen. Korbat kërcëjnë nga parvazi i dritares mbi tavolinë. Aty nisin e bëjnë kërdrinë, në fillim në copa buke, mandej në copa mishi:

Korbat m'rrijnë n'pamakun e dritares teme

Korbat hanë nga pak çdo ditë fisnikrinë teme

Korbat kërcëjnë në kuzhinë shkelin bukën që e ha

Korbat m'i marrin fjalët e bukra

Korbat ma nxjerrin mllefën për gjana t'vdekshme

Korbat ma nxjerrin frikën e lëndimit

Korbat ma shlyejnë kujtesën

Korbat m'krrokasin muzgjeve

Korbat i pengojnë me flatra kah unë me ardhë

Korbat më hanë mu

Korbat afrohen, por tonet largohen nga qendra, thellohen, duart shkojnë në drejtime të kundërta. Melodia e humbjes mprehet gjithmonë e më tepër në tone të larta që dora e djathtë mezi i mbërrin, kurse akordet e korbave, që bëhen gjithnjë e më të thella, e tërheqin dorën e majtë nga e kundërta.

Ndërkohë, këmba shtyp pa mëshirë pedalin që e mban jehonën gjallë, sa herë dhimbja mpaket a korbat prehen, jehona e dashurisë, ky mall i papërballueshëm, i fryn zjarrit dhe i jep hov djegies:

i dashtun

shpirt

frymarrja jeme

drita jeme

jeta jeme

heshtja jeme

tingulli jem

verbnia jeme

andrra jeme

dashunia jeme

Interpretimi bëhet gjithmonë e më i vështirë, pjesa është virtuoze, teknikisht gati e pamundur. Por poetja luan mjeshtërisht, a thua se e ka luajtur me qindra herë këtë pjesë. Por është e pamundur, apo jo? Sepse sa herë mund të të hanë korbata, sa herë vdes njeriu? Një herë, apo?

“Shumë herë” është përgjigjja e poezisë, çdo ditë, çdo mëngjes. Kjo grua është Prometeu që pret shkabën e vet çdo ditë, që e di si nis dhimbja, si shtohet, kulmohet, si vdes, humbet, mandej rilindet prej hiçit, e gatshme për ta rjetuar edhe një herë prej fillimit. Këtë skenë, ajo e ka jetuar me dhjetëra, qindra herë. Prandaj është i vështirë interpretimi. Sepse shpirti e di mirë skenarin, dhimbja e shndërron dalëngadalë:

më mbrojnë prej njerzve të mirë

Dhembja t'ban shpirtvogël nganjisherë

Butësinë ma ndryjnë me shtatë dryna n'shtatë ditë t'javës

Zanin që m' asht shtyp me shekuj errësie

Nuk m'lajnë pa të me jetue

I lanë vetëm gjanat e kqija mëngjeseve mbijetue

I zmadhojnë fajet e vockla prej njeriu, kërkim faljen n'fyt ma lanë

Mbetjet e fundit prej meje që dashunia jonë i la.

Honit po lshohem ngadalë

Pavrejtshëm me u shu.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Çfarë është dhimbja e humbjes? Çfarë e bën humbjen kaq të dhimbshme? Është e çuditshme që e vuajmë kaq shumë humbjen e dashurisë, kur e dimë qysh në fillim se gjithçka shkon drejt humbjes. Të gjithë shkojmë drejt vdekjes, çdo dashuri shkon drejt fundit. A thua ndodh kjo, sepse humbja e dashurisë na kujton pafuqinë tonë, na bën të ndihemi kaq të pafuqishëm? Aty ku dashuria na mbush me shpresë, na e mbush botën me njerëz, aty humbja na shkreteton, na kthen në vetminë e fillimit të jetës, në pafuqinë e fatit tonë. Por a e bën dhimbja njeriun njeri? Apo dhimbja e shkatërron njeriun brenda nesh, na shndërron në qenie të mllefosura, të hidhura, që brejnë veten. Gërryejmë veten me sqepin e futur përbrenda ose shkatërrojmë botën, hedhim njerëzimin në erë. Dhimbja është një bombë me sahat. A ka shpresë në honin e humbjes? A ka fund ky hon?

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Korba unë!

Korba unë!

Korba unë!

Leximi i poezisë "Kosovës" të Daim Miftarit

Kosovës

Mos u brengos për mua, Kosovë.

*Ta gëzosh pavarësinë,
e përvujtura ime.*

*Jam mësuar unë,
të jem i huaj në shtëpinë time.*

*Njëqind vjet Kosovë
dhe mbeta gjallë.*

*Dhe kam marrë plagë,
dhe mes plagëve kam ecur
e kam arritur deri këtu,
si ti Kosovë.*

*Dhe jam bërë pa sy
pa gojë jam bërë.
Jam bërë pa veshë
dhe pa mend në kokë.*

*Njëqind vjet Kosovë,
rritur jam
si bima nën hije,
si ti.*

*Se ishim një shtëpi Kosovë,
dhe shtëpinë na ndanë...*

*Dhe mbeta gjallë.
Dhe mbete gjallë.*

Njëqind vjet, Kosova ime.

Shkup 2008, 2018

(“Akuj”, Shkup, 2018)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Tema e poezisë “Kosovës” lexohet qartë që në titull. Është një poezi përkushtim, e ndërtuar në formën e një thirrjeje të drejtpërdrejtë. Poeti është thirrësi. E thirrura është Kosova, e personifikuar që në vargun e parë me aftësinë e saj për ta ndier poetin, për të ndier poetin. Toni i thirrjes është intim dhe i ulët:

Mos u brengos për mua, Kosovë.

Tingëllon si: “Mos u brengos për mua, nënë” ose “Mos u brengos për mua, e dashur”.

Me këtë thirrje, poezia rreshtohet menjëherë në një traditë të gjatë poezish thirrëse të Kosovës. Vetë fjala “Kosovë” evokon ndër shqiptarë një thirrje të brendshme, që i ka rrënjët e thella në historinë e kombit. Por thirrja këtu përfundon me pikë, jo me pikëçuditje. Më shumë se thirrje emocionale, që do t’ia shkundë malet dhe vlojë gjakun lexuesit, tingëllon si ofshamë.

E gjithë poezia ndërtohet mbi thyerje të pritshmërisë. Titulli e ndalon lexuesin në stacionin e këngëve patriotike, aty ku shkunden lisat, por e fut pa mendje në një livadh ku bimët e shpresës mezi mbahen gjallë.

Mbas thyerjes së tonit, në pritje i lartë patriotik, por në të vërtetë i ulët dhe pikëllimtar, vëmendjen e tërheq menjëherë thyerja me “ta gëzosh”:

Ta gëzosh pavarësinë

Jo “”ta gëzofsh”, që do të ishte forma e urimit në mënyrën dëshirore, por “ta gëzosh”. Nuk është urim, por është lejim, ftesë, lutje. E dashur, dua që ti ta gëzosh pavarësinë. Edhe nëse unë nuk kam ç’të festoj. Vazhdo gëzo ti të paktën, se unë jam mësuar kështu: *i huaj në shtëpinë time.*

Poezia thirret në Kosovën, por fokusi është në përjetimet në vetë të parë të poetit:

ime, jam, unë, mbeta, kam

Me dy thyerje të rëndësishme: “si ti Kosovë” dhe mandej sërish “si ti” dy strofa më poshtë.

Thyerja e parë mbyllet me një thirrje “Kosovë”, që rimerr atë të fillimit dhe sikur mbyll një strofë.

E dyta është ndryshe, ajo sikur hap kulmin e poezisë, ku rimerret thirrja në një eko më të gjerë. Nga *unë* dhe *ti*, zgjerohet në *ne* (unë dhe ti bashkë) dhe *ata*:

Se ishim një shtëpi Kosovë,

dhe shtëpinë na ndanë...

Rimarrja e metaforës “shtëpi”, konak, në përsëritje, është më e fuqishme. Metafora e konakut të prishur duket sikur do ta përshkallëzojë poezinë në rritje. Por tri pikat ia vrasin shpejt përdëllimin dhe të çojnë në rezultatin e ndarjes:

Dhe mbeta gjallë.

Dhe mbete gjallë.

Vargu i fundit përmbledh të gjitha elementet me të cilat ka luajtur poezia deri më tash:

Njëqind vjet, Kosova ime.

Së pari, dualiteti i tonit të urimit, pritshmërisë së tonit të lartë, siç e kemi zakon në urime përvjetorësh “100 vjet!” me atë tonin e pikëlluar dhe denoncues, një ndjenjë shpartalluese, se kështu gjithmonë e dashur, 100 vjet të ndarë. Dhe intimiteti në “Kosova ime”, që tingëllon sërish si “e dashura ime”. Është shumë e fuqishme kjo kundërvënie, si një dashuri që e lëmë të

shkojë. Thonë se dashuria më e madhe është ajo që të lë të lirë të gëzosh jetën tënde.

Kjo lojë me tonin e mban poezinë në kapërcyell të shpresës dhe pikëllimit, revoltës dhe dorëzimit.

Tashti është koha t'i rikthehesh poezisë dhe ta lexosh sërish.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Teknika e “Kosovës” është një lojë me paradokset dhe bazohet në thyerjen e pritshmërive. Një poezi që thirret si patriotike-epike në titull, por shtjellohet si lirike. Një poezi që thirret, por që në të vërtetë ofshahet.

Thyerjet janë edhe më të holla. Mjafton ta shohësh më nga afër këtë veçori nëpërmjet fragmentit të një vargu, që është padyshim kërthiza e poezisë:

i huaj në shtëpinë time

Me qenë në shtëpi, do me thënë mos me qenë i huaj. “Ndihu si në shtëpi!”, u themi miqve. Nga ana tjetër, mundesh me qenë pa shtëpi, i huaj gjithkund. Mundesh edhe me qenë si në shtëpi dhe i mirëpritur gjithkund. Por i huaj në shtëpinë tënde, ka një tragjizëm politik që e thyen, e kris në palcë poezinë. Sepse nuk ka zgjidhje, ndaj edhe bima rritet në hije. Në hijen e shtëpisë së vërtetë, konakut të madh, konakut etnik, aty ku përkasin si poeti, ashtu edhe Kosova e tij.

Po kështu fjalori i zgjedhur nga poeti, për shembull, e thyen copash pritshmërinë e një urimi me rastin e pavarësisë. Tri janë fjalët që e ngjyrosin poezinë:

brenga – gjendje shpirtërore e shqetësuar dhe e rëndë, trishtim i thellë nga malli për dikë, nga vuajtjet.

vuajtja – dhembje në trup; mundim trupor a shpirtëror.

plagë – vend i çarë, i prerë a i shpuar në trup me plumb, me thikë ose me ndonjë send tjetër;

Dhe “gjallë”, kjo fjalë që papritmas tingëllon shumë më pak se domethënia e saj. Nuk ka gjallëri aty, nuk ka jetë dhe shpresë, veçse vegjetim. Pa sy, pa gojë, pa veshë, pa kokë (ah, sa keq që poeti nuk i beson variantit “krye”, që do t’i kishte ushtuar edhe si rimarrje tingëlluese në “hije” dhe “ime”). Si ndihesh sot, Kosovë? Gjallë.

Lexoje edhe një herë poezinë, të lutem!

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Ndjesia e trishtë që të vjen në lexim, mbështetet në një nënshtrësë të poezisë që flet për ndjenjat e dyfishta të poetit përballë një ngjarje politike siç është Pavarësia e Kosovës. Që flet për paradoksin e fatit të shqiptarëve, të ndarë për së gjalli, duke ndërtuar konak të ri në truall të vjetër. Cili është atdheu im? Tragjizmi, poezisë i shtohet edhe nga këndi ku poeti është ulur dhe kundron: Maqedonia. I huaj në shtëpinë time mbeta, siç ishe edhe ti Kosova ime, por ti sot po feston. E gëzosh pavarësinë, Kosova ime. Vazhdojnë të mbeten gjallë, poeti dhe Kosova, në konakë të ndarë.

Poezia patriotike në shqip ka gati gjithmonë karakter epik, meqenëse duket se lind ende me shtysat e Rilindjes sonë kombëtare: përforcimi i krenarisë kombëtare dhe frymëzimi mobilizues. Madje, poezia patriotike e diasporës nuk lë vend për pikëllim dhe dorëzim. Ndjenja të këtilla do të konsideroheshin si tradhti ndaj angazhimit të përjetshëm patriotik. Por një poezi patriotike lirike si kjo e këtushmja tregon qartë se lirika mundet me qenë po aq denoncuese dhe frymëzuese, sa edhe epikja.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Mos u brengos për mua, zemër. Ta gëzosh pavarësinë prej meje. Jam mësuar unë të jem e huaj në shtëpinë time.

Leximi i poezisë “mjeseve mundesh me ba sende me dritën” të Ledia Dushit

*mjeseve mundesh me ba sende me driten
me iu ruejt me ba sy e sy e sy për me e gjujejt
mos me marrë frymë mjeseve tue kërkue gjumin gjithkah
mjeseve mundesh me i shtri një kah një lutjet gojëlangëta
t`mbramjes
t`Zotave t`ngulun t`zhgrehun n`vaj për Lutjen n`kambë
për tana herët që s`i je dhanë qiellit t`territ tue ia zhgulë pemët
mjeseve mundesh edhe mos me u lutë ma mbas diellit që t`ban
për lojë
e t`prish për gjumë tue pa ara e ara e ara t`lame n`ar me drapna
e drapna e drapna t`zhdukun*

(“n`nji fije t`thellë gjaku”, Tiranë, 2019)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Kjo është ndër poezitë që duhet të përgatitesh t'i lexosh disa, e disa, e disa herë. Kjo sepse është ndër ato poezitë që të buzëqeshin në fillim e të këndojnë në vesh që në leximet e para. Dhe ti si lexues mundesh me u shtriqë i kënaqur, duke u përkundë në atë melodi që përçohet në sipërfaqe. Dhe mendon se kaq ishte, kjo qe poezia. Por mos u dorëzo kaq lehtë! Ja po ta them që në fillim, Ledia Dushi nuk shkruan kurrë për lexues që kënaqen kollaj. Portat e parajsës poetike të saj janë të fshehura në bërthamën e fjalës. Janë si ato ilaçet e mbështjella me kapsulë, i fut në gojë dhe ndien vetëm shijen sipërfaqësore të mbështjelljes. Disa nga ju mund edhe të thonë: Oh sa e ëmbël! Ha ha ha, duhet ta gëlltitësh i dashur lexues, ta lejosh të përzihet me lëngjet e stomakut tënd, të të shkrihet në gjak.

Por le ta shohim pak sipërfaqen:

Një poezi e zgjimit. Shumë fjalë e sinjalizojnë temën, ai çasti i zgjimit, loja midis diellit dhe territ, mjesit dhe mbrëmjes, ai çasti kapërcyell syhapë a symbyllë? Çasti i palëvizshmërisë. Kohëzgjatja është disasekondshe, ndoshta. Por që në sipërfaqe ndihet rrjedha, apo jo? Të parat që e sinjalizojnë që në këtë lexim janë përsëritjet: rimarrjet vertikale “mjeseve mundesh” dhe rimarrjet horizontale “sy e sy e sy”, “drapna e drapna e drapna”. Nga njëra anë, përsëritjet krijojnë ndjesinë e rrjedhës së çasteve që shkojnë pashmangshëm drejt zgjimit dhe nga ana tjetër, ndjesinë e marramendjes dhe përthumbjes së sapozgjimit. Se kush është i qartë në ato momente. Poezia rri symbyllur para diellit. Mbrapa janë lutjet “gojëlangëta” të mbrëmjes, gojën lëng nga dëshira a nga vaji i Zotave dhe mandej goditja me drapër e metaforës:

për tana herët që s'i je dhanë qiellit t' territ tue ia zhgulë pemët

Kjo është një metaforë shumë vizive dhe e fuqishme, shkullja e pemëve qiellit të territ, që krijon një kontrast shumë interesant

me atë gjendjen e pafuqishme të parazgjimit. Të krijon idenë e një fuqie si ato që kemi në ëndrra, që për një arsye a një tjetër, s'mund të realizohen. E ndien se do të mundje të vrapoje një maratonë, por s'lëviz dot as këmbën. Poezia rri symbyllur para diellit. Mbrapa është gjumi i humbur. Gjumi i pagjumësisë së mosdhënies ndaj territ.

Tash hapi sytë dhe merr frymë!

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

A e lexove? Lexoje edhe një herë, është krejt e shkurtër. A e ndien rrjedhën?

Kjo është poezi e rrjedhës. Nga ato që krijojnë gjendje me fjalë që nguten njëra mbas tjetrës, pa pika dhe presje, pa thyerje të logjikshme vargjesh, veçse turrje përpara drejt fundit që nuk është një ujëvarë e rrezikshme, por një prag i ri rrjedhe, që nuk mundesh t'i shmangesh.

Një mënyrë e tillë të shkruari e ka një efekt anësor: të lë pa frymë. Fizikisht dhe metaforikisht. Ja lexoje këtë varg:

e t' prish për gjumë tue pa ara e ara e ara t' lame n' ar me drapna e drapna e drapna t' zhdukun

Lexoje me zë të lartë, a e ndien si jeton me frymën tënde dhe se si, kur mbaron, është e mbushur me frymën tënde, ndërkohë ty të duhet me u mbushë me frymë të re? Dhe nuk është gjatësia, sepse po të ishte kështu, çdo varg i gjatë do të na linte pa frymë. Por është një forcë e brendshme e vargut, që e josh frymën dhe nuk e lë të ikë pa i shkuar në fund. Një fenomen i tillë quhet edhe talent, me fjalë të tjera.

Mendoje se si një moment kaq i paqtë, në dukje i palëvizshëm, koha kur po të del gjumi, transmetohet me një vrull të tillë të brendshëm. Ëmbëlsia e leximit të parë të shtyn të mendosh se po noton këndshëm në liqenin e Shkodrës një

mëngjes të bukur. Ah, madje ndokush kthehet në shpinë dhe pluskon duke iu kënaqur diellit! Veçse këtu i thonë Drin. Dhe në Drin nuk notohet. Drini të merr me vete dhe të nxjerr aty ku do ai.

Ndërkohë, poezia rri palëvizshëm në diell, me sy mbyllur. Ajo çfarë të ndodh ty si lexues është efekti i saj, është ajo shtresa e nëndheshme që lëviz padukshëm. Ti mendon se është dielli që luan me gjumin, por në fakt është poetja që luan me ty dhe me leximin tënd. Ajo është zonjë përmbi gjuhën. Ku shkel ajo, e vendos gjurmën e saj mbi domethënien e fjalëve:

mundesh me ba sende me driten

Poetja na mëson se *sende* munden me qenë gjithçka që asaj i shkon në mendje, jo vetëm ajo që ti si lexues mendon se mund të jenë.

Kudo ku shkon ajo, ndryshon ritmi i vargut... dhe nëse ti ke arritur t'ia dëgjosh hapin, veç shpejton t'i dalësh përpara ara ara ara ara ara ara.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Zgjimi është një çast shumë fatal. E gjithë dita përcaktohet nga ai moment i shkurtër i parazgjimit; ai moment peshues kur gjithçka vihet në provë: A dua të zgjohem? A dua të rikthehem në jetë? A kam fuqi të zgjohem? A kam fuqi të rikthehem në jetë? A duhet të zgjohem? A duhet të rikthehem në jetë?

Është i vetmi moment kur mund ta përjetojmë pa pasoja të qëndrueshme (d.m.th. vdekjeprurëse) atë lojën midis vdekjes dhe jetës. Në gjumë jemi të vdekur, por të vdekur për t'u ringjallur. Qelizat rigjenerohen. Njëkohësisht edhe prehemi. Jeta na jep pak orë pushim nga çmenduria e përditshme që kërkon kaq shumë nga trupat tanë të mjerë, që veç shkojnë duke u harxhuar dhe

konsumuar. Çdo mëngjes është një mëngjes më pak. Vdekja e vërtetë ndodhet një mëngjes më tej. Por është edhe një mëngjes më shumë për t'u përballuar. Dhe një shtytje e brendshme na thotë: Prehu tash! Pusho! Harro! Për këtë arsye, disa orë para zgjimit në trup çlirohet hormoni i kortizonit, që e përgatit trupin kohë para. Kjo sepse duhet një forcë e madhe jo vetëm psikologjike, por edhe kimike, për ta përballuar këtë shkëputje nga vdekja e gjumit. Duhet një forcë gati mbinjerëzore për ta zgjedhur me dëshirë luftën e jetës. Ti zgjedh. *Mjeseve mundesh me u lutë ose mos me u lutë.*

Leximi i katërt (leximi i vetes)

I shtrëngoj sytë fort në diellin e mëngjesit. Bota mbushet me ngjyra të papara. Një mrekulli. Këto janë vetëm ngjyrat e mia. Askush s'mundet t'i shohë, përveç meje. Unë mund t'ua tregoj, t'ua përshkruaj, por ata munden veç t'i përfytyrojnë. Dhe t'i lexojnë drapna drapna drapna drapna drapna drapna të zhdukun.

Leximi i poezisë “Porsi një fëmijë” të Romeo Çollakut

Porsi një fëmijë

Shkallareve dy karriget e vjetra kishin mbetur përfund, ashtu siç i patën nxjerrë atë paradite për të fotografuar gjyshërit.

Pastaj ra shi, pastaj u ngrit një erë e i flaku, njëren andej - tjetrën këndej, mbi rrasat e oborrit.

Nga shtëpia kundruall, i përhënuri ka mënjanuar paksa perden e dritares dhe dredh cigar e sodit këtë skenë.

Dhe kujton atë ditë me diell, ditën kur dhe zogjtë buzëqeshnin në parvaz, ylberin, kërricin që vraponte i lumtur në sokak, lulet e kumbullave, gjelbërimin e hardhive e, sidomos, fotografen flokëverdhë, me këmishë fanellatë me kuadrata, pantallona kadife dhe sandale të lehta.

Mbyll perden e dritares dhe zë, rishtas, e qan, porsi një fëmijë që i kanë vjedhur kaleidoskopin.

(KULTPOINT, 2018: <http://www.kultpoint-albania.com/romeocollaku>)

Leximi i parë (ose rrëfimi i një fotografimi)

Gjëja e parë që vërej gjatë leximit, është mënyra si janë ndërtuar vargjet. Ngeshëm. Vargje të ngeshme, që nuk nguten të thyhen, por e ndjekin mendimin deri në fund. A thua se ka kohë, ka kohë më vonë, për t'i shkuar mbas marrëzisë së thyerjes poetike. Ndërprerjet e gjera mes vargjeve, si ato që zakonisht janë midis strofave, ia ruajnë ritmin poetik dhe atë dukjen e poezisë, që lexuesit e kornizuar e duan medoemos (se u bëmë si këmbët e dhisë, pa rimë po, pa vargje po, të paktën strofa!)

Shkallareve dy karriget e vjetra kishin mbetur përfund, ashtu siç i patën nxjerrë atë paradite për të fotografuar gjyshërit.

Talenti i përzgjedhjes së fjalëve i jep poetit një skenë të plotë në një rresht, lexuesi i sheh krejt qartë ato dy karriget e vjetra në fund të shkallëve. Paralelisht, aktivohet dhe koncepti i kohës që qysh në krye është thjerrëzuar në shumë sipërfaqe:

- Koha, si përshkrim figurativ me metaforën e jetës në mbarim: dy karrige të vjetra – gjyshërit – përfund shkallëve.
- Koha si përshkrim fizik: një paradite dhe foljet në kohë të kryera.
- Fotografia, kjo përpjekje njerëzore për ta ndalur e fiksuar kohën. Kjo dëshmi e pakundërshtueshme e faktit që koha kalon dhe nuk kthehet më.

Pastaj ra shi, pastaj u ngrit një erë e i flaku, njëren andej, tjetrën këndeje, mbi rrasat e oborrit.

Në diapozitivin e dytë shihet qartë se koha ka lëvizur që nga ajo paradite. Nga njëra anë në përsëritjen e ndajfoljes kohore *pastaj...*, *pastaj...* dhe nga ana tjetër, sepse krejt vargu mbështetet në të kryerën e thjeshtë. Kjo kohë krijon rëndom një atmosferë

enumerative sendesh që ndodhin njëra pas tjetrës, mbaron njëra, fillon tjetra, pastaj, pastaj.

Nga shtëpia kundruall, i përhënuri ka mënjanuar paksa perden e dritares dhe dredh cigare e sodit këtë skenë.

Tashti lexuesi ka perspektivën e duhur, e kupton nga po e sheh këtë oborr. Më në fund, skena e ka një pikënisje të vështirimit. Kundruall. Edhe këtu, koha është në lëvizje. Ka filluar para se ta vëmë re të përhënurin, në momentin që ai ka mënjanuar perden për të kundruar skenën, edhe pse lexuesi ende nuk e dinte se ai ishte aty. Dhe vazhdon e lëviz në të tashmen. I përhënuri dredh cigaren. Soditja nuk është e shtangur, nuk është fotografike. Ajo skenë është si një buton i fshehur që sa e ndesh, e ndërron skenën krejt.

Dhe kujton atë ditë me diell, ditën kur dhe zogjtë buzëqeshnin në parvaz, ylberin, kërricin që vraponte i lumtur në sokak, lulet e kumbullave, gjelbërimin e hardhive e, sidomos, fotografen flokëverdhë, me këmishë fanellatë me kuadrate, pantallona kadife dhe sandale të lehta.

Një varg i lidhur për fyti me fillin e mendimit të të përhënurit. Një kujtim i njëfrymshëm që nuk duron thyerje, një rrjedhë kujtimi që i vërshon në krye si përrua i rrëmbyeshëm. Atij dhe lexuesit. Vargu vërshon nga jashtë brenda dhe nga dritarja hyjnë të gjitha: zogjtë, ylberi, kërrici, lulet, hardhitë dhe sidomos fotografia flokëverdhë. Ashtu, me këmishë fanellatë me kuadrate, pantallona kadife dhe sandale të lehta. E me to hyjnë të gjitha diskutimet se ç'është poezia. P.sh., merre këtë varg dhe vendose në një kontekst proze; do të dukej si të ishte karakterizim i një ngjarjeje. Vendose këtu dhe e ke varg poetik, jo për dukjen, por për mënyrën si ta kap zemrën me gishta të ngjyer me strugimento

(oh, pse nuk e gjej në shqip këtë fjalë... Mall? Dëshirë? Dhimbje që ma bën zemrën copa, shqipe mos më lër në shi tashti!).

Mbyll perden e dritares dhe zë, rishtas, e qan, pors i një femijë që i kanë vjedhur kaleidoskopin.

Dhe poezia mbyllet në lot. Një zgjidhje e tillë ishte e pashmangshme, gjithë ai vërsim shtrydhës dhe ndrydhës, por edhe shpërthyes dhe shkatërrues, “struggente” ma, e lodh aq shumë lexuesin sa sytë të mbushen vetvetiu me lot. Kjo, nëse e ke lexuar me zemër të hapur, ashtu si poeti e ka shkruar, me zemër. Se një poezi e shkruar me mendje të hollë nuk t’i mbërrin kurrë cepat e syve.

Leximi i dytë (ose në duart e një të përhënuri)

Është interesante se si në të gjitha gjuhët që njoh, njerëzit e paqëndrueshëm i krahasojnë emocionalisht me hënën. Hëna, kjo e paqëndrueshme e përjetshme, gjithmonë në ndryshim, gjithmonë në lëvizje. Hëna kjo lunatike per definizione.

Çfarë ndodh kur poezia është në duart, ose më mirë me thënë në sytë, e një lunatiku, një njeriu “që ka shumë teka e trille, që e ndërron mendjen orë e çast e nuk di as vetë se ç’dëshiron e se ç’kërkon; që nuk e përmban dot veten*” (*nga Fjalori) Për të parë nëse e ka ndonjë efekt, të provojmë ta ndërrojmë të përhënnur in me një burrë të zakonshëm. Po e përdor në trajtë të pashquar, meqë lagjja zakonisht ka shumë burra, por vetëm një të përhënnur të njohur. Lexoje poezinë njëlloj, vetëm se vargun e tretë lexoje në këtë mënyrë:

Nga shtëpia kundruall, një burrë ka mënjannuar paksa perden e dritares dhe dredh cigar e sodit këtë skenë.

Gjërat shkojnë mjaft mirë deri në vargun e fundit, apo jo? A thua është fakti se i bien që burri qan, që nuk pajtohet me ndryshimin e kryefjalës? Se burrat nuk qajnë? S'ma merr mendja, për dashurinë, burrat qajnë edhe në shqip. Apo sepse qan si fëmija kur i marrin lodrën e preferuar? S'ma merr mendja, shqipja e përdor si shprehje këtë “qau si fëmijë”, d.m.th. qau me shpirt. Apo sepse bashkëvendosja e një të rrituri (që madje dredh cigare) me një lodër fëmijësh krijon inkonsequencë dhe e prish ekuilibrin e rrëfimit? S'ma merr mendja, poezitë shpesh marrin frymë në inkonsequenca, sidomos të papritura. Çka i mbetet më vargut të fundit? A e sheh? Atë fjalën e vogël, të bllokuar me presje, si një ndajshim i rastësishëm? Atë fjalën që rri varur për buzën e të përhënit, si ato copëzat e letrës së duhanit, pasi i ka lëpirë me gjuhë?

Rishtas

Kjo fjalë është e lidhur direkt me të përhënit. Edhe një njeriu të zakonshëm i ndodh që një ditë në dritare t'i kujtohet një skenë e ndodhur shumë kohë më parë e të shkrihet në vaj. Si fëmijë. Por “rishtas” është tjetër, sepse nënkupton një cikël që përsëritet sërish dhe sërish. Skena shkon në reprizë dhe ka shkuar në reprizë kushedi sa herë. Realizimi se gjithçka ka kaluar dhe nuk kthehet më, vërshon nga jashtë brenda kohë e pa kohë, gjithnjë në ndryshim, nën peshën e tërheqjes së hënës. Edhe poezia vetë e ka një efekt lunatik në lexuesin. Sa herë e lexon, ia rikujton këtë *struggimento*, këtë pafuqi para asaj që ka shkuar dhe nuk kthehet më. Dhe mund ta lexosh sa herë të duash dhe njëlloj ta ndiesh, herë më fort e herë më pak, por gjithnjë aty, rishtas, gati për ty. Sepse kush arrin ta ripërjetojë e ta shohë nga kënde të ndryshme ka një dhuratë të veçantë në jetë: *kaleidoskopin*.

Leximi i tretë (ose vjedhja e kaleidoskopit)

Jo të gjithë e kemi dhuntinë e kaleidoskopit, atë dhuntinë për ta parë jetën nga këndvështrime të ndryshme dhe për të gjetur një kuptim a bukuri në të gjithësesi. Disa mbesin gjithnjë në të njëjtën rutinë, sado ta shkundin gypin, nuk shohin veçse të njëjtën pamje logjike. Një shkallare, dy karrige të rrëzuara nga era dhe shiu. Kaq. Banorë të pakujdesshëm të shtëpisë së oborrit me rrasa, që nuk janë kujdesur t'i fusin brenda ato dy karrige pasi i kanë nxjerrë jashtë. Por disa e kanë dhuratën e kaleidoskopit. Çdo skenë merr jetë, i futet në gjak, a thua se po ndodh prej vërteti. Dhe nuk ka rëndësi nëse është reale apo jo. Koha mundet me qenë një kaleidoskop i mrekullueshëm në syrin hënor. Mjafton ta përjetosh. Vjen mandej momenti i zgjimit. Mbas çdo seance kaleidoskopike, vjen vetëdija se koha ndërkohë ka lëvizur, se diçka ka humbur. Diku aty mes pasqyrave të kaleidoskopit ka mbetur pak nga vetja jote.

Leximi i katërt (ose leximi i vetes)

Dikur, kur isha 10 ose 11 vjeçe, kisha në klasë një djalë të veçantë, me fantazi të pazakontë dhe talent të jashtëzakonshëm për eksperimente. Humbi mandej, pa nam e nishan. Domethënë humbi nga jeta ime. E mendoj nganjëherë, ku bëhet tashti, ç'u bë? A thua shkencëtar? Shpikës? A ndoshta shoqëria jonë me ndarje të kornizuara ditë/natë ia mbyti hënën dhe bëri të zakonshëm, ose e hodhi poshtë nga hëna?

Një ditë kishte mbledhur një fletore si gyp dhe e kishte lidhur. Mandej e kishte mbushur me grimca letre dhe e kishte mbyllur me një letër alumini dhe me garzë të hollë në të dyja anët. Rrinte në diell, në oborrin e shkollës, në ato çaste të rralla paqeje prej përndjekjeve nga djemtë e tjerë, e tundte gypin dhe shihte nga dielli.

– Provoje, – më tha. – Çfarë sheh?

– Grimca letre – i thashë.

– Po, po, por a sheh si bashkohen në forma të ndryshme?
Çfarë formash sheh?

– Unë shoh veç grimca letre.

Ai nuk më besoi. Ma mori gypin nga dora dhe e shkundi fort.

– Provoje përsëri!

Unë u ndieva në siklet. Ç't'i thosha, ato grimca të mallkuara letre më ishin ngjitur për syri dhe nuk shihja gjë tjetër veç asaj që ishte e qartë dhe e kuptueshme, dhe e klasifikueshme, dhe e parashikueshme.

Mbyll perden e dritares dhe zë, *rishtas*, e qaj, pors i një fëmijë që i kanë vjedhur kaleidoskopin.

Leximi i poezisë “sot është një nga ato ditët” të Enkeleda Ristanit

sot është një nga ato ditët

sot është një nga ato ditët

ato ditët paraciklore

jo detyrimisht menstruale

një nga ato ditët kur kujtohem sa bosh tingëllon zëri im

sa ftoftë bën brenda meje krahasuar me stinën jashtë dritareve

një nga ato ditët që vijnë mbas ditëve të qarkuara me buzë

moskokëçarëse

unë u ngjaj menstruacioneve të mia

nuk jam gjaku

jam qerthulli

para gjakut byme hem nën lëkurë

fryhen dështimet si lumenj mbas shirash

krekoset gjithë pafuqia ime mbi plehun e kujtesës

jashtë është shëmti e brenda më shumë

mbërrij krisjen e lëkurës sa gjaku të shpërthejë

dhe me siguri do qetohem me harresë.

(“Nesër është e vona ime”, Durrës, 2014)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

A u skuqë? Apo u nxive? A u zverdhe? U zbardhe? Apo u mavijose? Jeshilose? Apo hiç? Leximi i parë i kësaj poezie është, me dashje a pa dashje, si i magjepsur mbas kësaj fjale: menstruacione. Leximi i parë është leximi i më së dukshmes në sipërfaqe, prandaj: menstruacione.

Por pa e normalizuar ngjyrën e fytyrës në leximin e kësaj fjale, nuk mund të vazhdojmë të lexojmë poezinë. Dhe sa më shpesh e lexon, aq më tepër normalizohet: menstruacione. A e vë re ndryshimin? Menstruacione. Nuk është aq e rrezikshme. Menstruacione. Tashti merr frymë thellë dhe lexo poezinë.

A e sheh tash se për çfarë flet poezia? Flet për një nga ato ditët kur gjithçka duket më e vështirë nga ç'është, kur boshllëku është më bosh se zakonisht, kur dështimet përjetohen më të rënda se zakonisht. Poezia mbartet nga një figurë po aq e vjetër sa vetë ajo: vendosjen paralele të një gjendjeje shpirtërore me një fenomen natyror a biologjik që i ngjason.

Ashtu sikurse fryhet dhe bymehet trupi i gruas në ditët përpara menstruacioneve, ashtu në këtë ditë të poezisë fryhet dhe bymehet trishtimi. Është ai trishtimi i pafuqisë para asaj që ndodh, pa arsye dhe logjikë, vetëm pse është. Vetëm pse je njeri dhe me qenë njeri është e vështirë. Është pafuqia që krekoset në plehun e kujtesës, si gjeli i shprehjes popullore, për t'u harruar mandej. Kjo lojë midis kujtesës dhe harresës është ajo që e shtyn njeriun rreth e përreth pa e lënë të mbytet në moskuptimin e jetës.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Në fakt, tash që lexuesi mund ta lexojë poezinë pa ndërruar (dukshëm) ngjyrën e fytyrës, mund të vërejë se poezia është ndërtuar si një rreth. Forma e poezisë mbahet nga fjalët *cikël*, *qark* dhe *qerthull*:

ditëve paraciklore

ditëve të qarkuara

jam qerthulli

Domethënia e të tria fjalëve shënon një varg ngjarjesh që ndjekin njëra-tjetrën në një ritëm të caktuar, një varg ngjarjesh që përmbillet aty ku nisi duke krijuar një figurë rrethore.

Tashti mendoje veten me një kompas gjigand në dorë, ngule fort gjilpërën para këmbëve dhe hiq një rreth me veten në qendër, nga e majta në të djathtë, një rreth të mbyllur. Pika fillestare është para teje, aq sa mund të shtrish duart, pak majtas ndoshta. Mos u kthe nga njëra anë në tjetrën, ti qëndron pa lëvizur, vetëm zgjatësh mbas kompasit duke u munduar të mbërrish të gjitha pikat e rrethit:

– Filloje rrethin në pikën sot, sepse sot është “një nga ato ditët kur kujtohem”.

– Vazhdoje në pikën tjetër, që është momenti kur ndien “sa ftohtë bën brenda meje krahasuar me stinën jashtë dritareve”, pikërisht aty ku nis enjtja e dëshpërimit. Uni e shtrëngon kompasin fort dhe e rrit intensitetin e vizatimit, vija lakohet pa vështirësi, pika vazhduese është pak në të djathtën tënde “jashtë është shëmti e brenda më shumë”. Tashmë je zgjatur nga e djathta, lëkura kris.

– Mbrapa teje vizato vijën e lakuar të derdhjes.

– Mandej vazhdo me harkun e qetisë, të harresës. Vija rrethore aty mezi përvijohet, sepse është më e vështirë të arrihet, meqenëse është në kah të kundërt me ty. Vija mbrapa teje harkohet në të ardhmen (*do qetohem me harresë*).

– Qarku mbyllet mandej aty ku filloi, para teje, ndoshta pak majtas, në ditët e qarkuara me buzë moskokëçarëse, ato ditët para së sotmes. Para kësaj dite të poezisë, vinin ditët e harresës, kur

brenda ishte po aq ngrohtë sa jashtë.

Vija e lakuar e rrethit para vetes është e dukshme qartë, se është më e lehtë të vizatosh para vetes me kompas; mbrapa mezi shquhet. Por cikli mbyllet dhe me të një varg i plotë shndërrimesh që kryhen brenda një kohe të caktuar, një cikël që do të përsëritet sërish e sërish. Jo detyrimisht cikël menstrual. Kundroje tashti! A nuk të duket se ke vizatuar qerthullin e qenies njerëzore, pashmangshmërinë e fatit njerëzor?

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Që në leximin e parë, kjo poezi të mbush kryet me mendime, siç bëjnë zakonisht poezitë e gjendjeve shpirtërore. Por duhet t'ia pranoj vetes se kjo poezi, së pari, mbetet një poezi emancipuese. Jo emancipuese në kuptimin që po i tregon botës se ç'janë menstruacionet, edhe nëse e bën këtë. Apo se po i tregon botës se nuk ka asgjë të turpshme, të rrezikshme a të ndyrë me menstruacionet, edhe nëse e bën edhe këtë. Ka edhe në shqip disa poezi të rralla që e trajtojnë këtë temë.

Kjo poezi është emancipuese për poezinë shqiptare, sepse është çliruese. Deklamon lirinë e gruas për të shkruar për përvojat e trupit të saj. Përvoja që mund të bëhen poezi siç mund të bëhet poezi çdo përvojë e mirë njerëzore. Sepse poezia nuk qëndron në pikënisjen, por në përjetimin e krijimit.

Gjysma e lexuesve e dinë si ndihesh në ditët para, gjatë dhe mbas menstruacioneve; për to cikli i menstruacioneve është cikli i jetës. Dhe nëse kjo është një nga ato ditët kur ndihesh ashtu, atëherë *botë mbahu!*, sepse rrugët e poezisë janë krejt të paparashikueshme.

Dhe vdekja mandej. Kjo e ardhme që na përvijohet mbas shpine, si një cikël që përsëritet sërish e sërish. Dhe derdhja si një metaforë e vdekjes. Trishtimi i jetës që nuk u ngjiz, por derdhet.

A thua vdekja është derdhje, zbrazje, ajo ndjesi e qetësisë së plogësht që të pushton mbas. Ajo pika e qarkut kur ti shkon në harresë, në paqe?

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Mbahu! Me siguri do qetohem me harresë.

Leximi i poezisë “Tokës” të Shqiponja Axhamit

Tokës

*Sot fshatarët, m'u ulën pranë
moj toka ime e pambjellë!
Dilemat janë përsiatje,
guximi është për të paepurit;
ata s'e dinë:
unë thjesht i dëgjoj
me sytë ngulur në ty;
u bë kohë që hardhitë e tua
lëshojnë lastarë të zbehtë.
Oh, mungojnë krahëzbuluarat
që të mbledhin rrushin për verë;
llërët e tyre të zbuluara
mbi plazmën e kuqe.
U bë qiparis,
u shuajt si plak me naze
ky fshat i imët, dhe unë,*

*unë e përhumbara në mendime
 vij e shkoj si një enë bakri
 që nuk bindet të ndryshket,
 me gerrat e një fisi gdhendur në sy.
 Dega e kumbullës në hije u thye:
 ra në përroin e luleve të egra -
 djepi i harruar; vijnë e shkojnë në luginë
 tufa më trumcakë të hutuar.
 Më thuaj, moj toka ime e pambjellë,
 kë të qaj tani? Në m'u bëfsh varr,
 lëri skifterët të sqepojnë mbi mua
 ditën kur të ndjej në lagjen time
 vajin e ndonjë fëmije...*

Do të gjerb mbi ty frymë...

(“Zoti zbret mbi jaseminë”, Tiranë, 2016)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Poezia është një përkushtim, siç e sinjalizon rasa dhanore e titullit: Tokës. Toka? Trualli? Dheu? Dilemat se për cilën tokë bëhet fjalë, ndërpriten menjëherë (se dilemat s'janë veçse përsiatje) që në fillim të poezisë: kemi fshatarët në njëren anë dhe tokën e pambjellë në anën tjetër. Këto dy koncepte, në thelb të kundërta, meqë toka e pambjellë të jep idenë e një toke të braktisur, ndërsa fshatarët që të ulen pranë nënkuptojnë jetë dhe të mbjella, e transportojnë poezinë menjëherë në një plan tjetër nga ato që të thonë fjalët. E transportojnë në planin e metaforës, ku e vetmja që ulet, është poetja. Ajo ulet në tokën e saj të pambjellë dhe ia nis kujës, të sinjalizuar nga thirrja “moj toka ime e pambjellë!”. Të gjitha poezitë që thërrasin me thirrma dhimbjeje, zemërimi, predikimi apo oh-e dashurie, rrezikojnë shumë. Sepse thirrja e kërkon një fokus dhe një vëmendje të lexuesit në poezi, që kjo duhet të dijë ta mbajë, ndryshe bëhet qesharake, bajate, akrobate, llapacake e të tjera –ake dhe –ate si këto. Për ta mbajtur duhet që poeti vetë ta ketë ndier deri në fund, t'i ketë ardhë nga zemra, t'ia ketë vleruar gjakun para se ta lëshojë në mua si lexues. Por kur ia mbërrin, atëherë thirrjet janë si ai i shtrëngimi i lidhëses së këpucëve në mes të rrugës, ndalesh, e shtrëngon dhe mandej ecën më lehtë. Tri herë thërret poetja:

1. moj toka ime e pambjellë!

*2. Oh, mungojnë krahëzbuluarat
që të mbledhin rrushin për verë;*

*3. Më thuaj, moj toka ime e pambjellë,
kë të qaj tani?*

Të tria herët ma shtrëngon zemrën dhe më detyron të mbushem me frymë. Me frymën e saj.

Sipërfaqja e poezisë ka dhe karakteristika të tjera, që edhe syri i thjeshtë i sheh qartë. Shenjat e një toke të braktisur, për shembull. Hardhitë rrisin lastarë të zbehtë (në kontrast me plazmën e kuqe të rrushit) dhe degët e kumbullës të mbetur në hije që thyhen. Këto pemë pjellore vdesin në kundërshti me qiparisin, pemën e varrezave, që ua zë vendin. Përroi i luleve të egra është një djep i harruar, lugina mbushet dhe zbrazet nga trumcakë që vijnë e shkojnë hutueshëm.

Pjesa e fundit e poezisë e shton intensitetin e kujës, me deklamimin “kë të qaj?”. Përdorimi i formës së dëshirores “m’u bëfsh” i jep pak karakter këngësh popullore. Edhe ky përdorim në poezi është i rrezikshëm, në kuptimin që mund të anojë lehtë me tepri nga folkloristikja dhe ta bëjë sërish poezinë –ake dhe –ate, siç e thashë më lart. Por kur e përdor mirë, e ngjyros stilistikisht poezinë dhe mbart në të gjithë fuqinë e rrallë që ka dëshirorja e shqipes. Edhe këtu kemi një lojë kundërshtie midis varrit dhe skifterit. Është qyqja që vjen te varri, janë korbata që i sqepojnë kufomat. Skifteri mund të vijë të ta sqepojë zemrën për së gjalli, por jo për së vdekuri. Ky skifter duket më shumë si shkaba e Prometeut. Kjo kundërshti i hap rrugën metaforës së fundit: *do të gjerb frymë* – do të ngjalle. Mbi ty, toka ime e pambjellë!

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Në leximin e dytë, mund të vëresh se si nën rrjedhën e rrëfimit të poezisë, rrjedh edhe një rrëfim i kohës i nënvizuar nga fjalë si:

sot

u bë kohë

tani

ditën kur

do të (si shenjues të kohës së ardhme)

Koha e ndan poezinë në dy pjesë. Nga fillimi deri në thirrjen e dytë të “moj toka ime e pambjellë” kemi kohën e tashme “sot”, “tani” dhe historinë. Sot kemi vetëm poeten dhe fshatarët që i ulen pranë, por në terrin e historisë kishte hardhi, verë, rini, kumbulla. Atje, në terr, ka jetë.

Mandej nis përfytyrimi i së ardhmes. “Në m’u bëfsh varr” me një skifter që siç e thashë më lart, nuk sqepon vdekjen, por të gjallin. Se ajo është një vdekje e rreme, është një djep, edhe pse i harruar. Se varri është edhe terr, takimi me atë terrin e historisë, terrin e jetës së dikurshme, që pret ujitjen e lotëve të fëmijëve për t’u ringjallur, për ta gjerbur, pirë ngjalljen përmbi, jo në të.

A të kujton diçka kjo ulja, zhytja në terr dhe ringjallja? Mua më kujton mbjelljen e farës. Mendoje tashti farën: Fshatari ulet dhe e zhyt farën thellë në terrin e dheut. Aty fara pret e pret, gjysmë e vdekur, por njëkohësisht e gjallë. Një ditë, kur bën ngrohtë dhe bie shi, ringjallet, mbin. Dhe del mbi tokë.

Kështu, poetja e rrëfen vuajtjen e tokës së pambjellë me ritmin e farës, e rrëfen mungesën me objektin që i mungon. Në mënyrë të vetëdijshme, a të pavetëdijshme, sepse talenti e gjen vetë rrugën e rrëfimit të poezisë.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Rrëfen një histori të trishtë kjo poezi. Toka dhe fshatra të braktisur. Aty ku rridhte vera e rrushit të kuq, tashti rrjedhin vetëm përrenj me lule të egra. Por ai që mua më fut në mendime, është bashkëbisedimi i fillimit, që në njëfarë mënyre tregon arsyen se pse ndodh:

guximi është për të paepurit;

Duhet guxim për të qëndruar, për të vazhduar atë mënyrë jete si brezat e mëparshëm. Kërkon një paepje, një mosdorëzim, që është i vështirë të arrihet. Dilema mes jetës së dikurshme, kur lumturia arrihej me mjete të thjeshta (idealizuar në poezi me llërëpërveshura që vjelin rrushin) dhe një jete të re më pak të mundimshme fizikisht, është një përsiatje që e ka përndjekur njeriun në dy shekujt e fundit. Dhe nuk e di ku do ta shpjerë. Shumë kthehen, në kërkim të asaj ideale të së kaluarës, të tjerë ikin përgjithmonë. Dilemat s'janë veçse përsiatje.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Poezia është farë. Mbin dhe ngjallet nga lotët.

Leximi i poezisë “Vegim” të Ndue Ukajt

Vegim

*Më sëmbon diçka
teksa si anije kthehem nga dallgët
drejt limanit të kujtimeve.
Aty është koha e pashkruar. Ankorimi i ngadalshëm.*

*Është vjeshhtë e hershme
e një zog këndon si më parë.*

*Dielli shtrihet mbi tokë e qyteti zgjohet i zhurmshëm
anija ime i afrohet qetësisë.
Matanë kujtesës, një kambanë
paralajmëron tregimin e pakryer.*

*Gjethet e kuqërremta vazhdojnë të jenë kurora e imagjinatës sime,
E qiellit tim.
Është muzg. Jehu i detit ma mbush gjoksin me një dëshirë:*

Lirinë e peshqe.

Ah, kjo zonë është e ndaluar për peshkim.

*Por një anije luftarake shkeli ligjet ndërkombëtare
dhe kushedi sa peshq vrau.*

Ne zbresim poshtë e më poshtë

dhe dielli shkëlqen e deti duket si kristale mëngjesore.

*E nga toka dëgjohen notat e një melodie-
një melodie që s'dua ta deshifroj.*

(HAEMUS nr. 51-53, 2015, f. 95)

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Poezia “Vegimi” e ka pikënisjen në një metaforë të vjetër sa vetë poezia: shpirti i trazuar i poetit (anija në dallgë) gjen paqe dhe ngushëllim në kujtime (limani). Poeti nis drejt kujtimeve si anija drejt limanit, këtij vendi të mbrojtur nga stuhitë, të mbrojtur nga koha që kalon. Aty në liman, koha është ende e pashkruar, por rishkruhet sa herë që vjen anija e poetit. Tregimi është i patreguar, por tregohet kur shfaqet anija e poetit.

Toposi i vegimit e shoqëron krejt udhëtimin: ancorimi është i ngadalhtë, në *slow motion*. Anija i afrohet qetësisë, gati rrëshqet në ujë. Shqisa më e ndieshme e këtij vegimi është shqisa e dëgjimit:

e një zog këndon si më parë

qyteti zgjohet i zburmshëm

një kambanë paralajmëron

Jehu i detit

notat e një melodie

Shqisa e të parit shkon paralel me dëgjimin dhe krijon e rikrijon gjethë të kuqërremta në imagjinatë. Vegimi andej është shumë tokësor, me gjethet si simbol të tokës, të limanit, por njëkohësisht është i largët, siç shihet toka vagullt nga deti. Atje janë kambanat, qyteti, zogu. Këndej gjendet poeti, me elementet e detit, anije, peshq.

Në mes tyre është ancorimi, ky sëmbim që e lidh anijen me tokën. Ne ancorim duket se mbahet e gjithë poezia. Një ancorim i ngadalshëm që ndodh dhe nuk ndodh, sepse melodia vazhdon

të vijë nga toka dhe toka përmendet kështu veç kur je ende në det. Dhe si në një vegim, tashmë të shndritshëm në diell.

Ne zbresim poshtë e më poshtë

dhe poezia largohet e padeshifruar.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Ajo që më josh ta lexoj sërish këtë poezi është ndjesia se diçka nuk shkon, se nuk qe thjesht një anije që iu rikthye limanit dhe iku tutje.

E para është parafjala “nga”, që ma bën leximin lëmsh: kjo parafjalë e bekuar e shqipës, që shënon si vendin për ku je nisur, si vendin prej ku vjen. Nga shkon ky vegim? Shkon apo vjen? Ku ndodhet limani? Ku ndodhen dallgët? Përpara apo mbrapa?

Lexoje edhe një herë poezinë, të lutem!

Kthehem nga dallgët drejt limanit, thotë poeti. Në lexim të parë, më vjen si “kthehem prej dallgëve”, si “vij prej dallgëve”. Apo është në kuptimin “kthehem përkundrejt dallgëve”, me fytyrën nga deti? Papritmas, poezia më shpërfaq dy botë të shtresëzuara njëra mbi tjetrën: Në njërën, poeti vjen nga dallgët e jetës dhe hedh spirancën në limanin e mbrojtur të kujtimeve, hyn nga realiteti me dallgë në vegimin ngushëllues. Kjo është udha më e zakonshme që ndjekin poezitë. Anija e poetit vjen nga dallgët dhe gjen prehje në limanin e përfytyrimeve. Tregimi i pakryer dhe koha e pashkruar e lejojnë poezinë ta tjerë e ta shtjerrë qiellin e vet simbas dëshirës. Është mëngjes, mandej, muzg. Është qetësi, mandej, zhurmë. Është ankorim, mandej, ikje, zbritje teposhtë. Si në botën e vegimit. Ku gjithçka është e lejuar.

Por kur ia mbërrij fundin kësaj bote, një tjetër nxjerr kryet.

Pikërisht në bashin e anijes luftarake, që shfaqet kërcënueshëm nga fundi i poezisë dhe e shpërndan pa mëshirë paqartësinë e vegimit. Kjo më shtyu ta lexoj poezinë për herë të dytë. Kjo anije luftarake që duket sikur shfaqet prej hiçit, por që ndoshta ka qenë aty prej fillimit “teksa si anije kthehem”. Një anije që vret dhe një anije që largohet. E njëjta? Njëra që ikën në kërkim të prehjes dhe tjetra që e përndjek nga e kaluara?

Në lexim të dytë, vërej papritmas se dy planet e poezisë, deti dhe toka, mund të ndërrojnë edhe vendet. Vargjet e mëposhtme,

qyteti zgjohet i zhurmshëm

anija ime i afrohet qetësisë

më krijojnë imazhin e ikjes nga zhurma, nga qyteti, dhe afrimit të një tjetër liman, që nuk është tokësor. Është deti, me jehun e tij, me ëndrrën për liri që e fton në mëngjes ku dielli shkëlqen mbi detin kristalor. Në këtë lexim, vegimi ngushëllues përmbushet, poeti rrëshqet tutje, në det të hapur, mes dallgëve, aty ku peshqit janë të lirë.

Dhe ankorimi i ngadalshëm ndodh, siç ndodh sëmbimi.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Poezia e mirë e shtyn lexuesin pashmangshëm në një lexim të tretë, leximin e mendimit. Poetët e talentuar mbjellin mendime dhe përjetime në dheun tonë. Leximi i tretë e ndihmon lexuesin të ndjekë fillin e mendimit të poetit dhe fillin e mendimit të vet.

Një Uliks më avitet në këtë poezi. Me ose pa emër të vet avitet gjithmonë një Uliks në poezitë e burrave. E lexoj strofën e parë dhe mendoj: ç’është kështu me burrat dhe Uliksin? Ç’ka kjo figurë që ua mëshiron kaq fort ëndrrat, sa nuk mund t’i ndahen?

Të jetë udhëtimi? Mundësia për të udhëtuar gjatë në vend që të mbërrish menjëherë në shtëpi dhe t'i vësh shpatullat punës? Gratë e ndryshme nga ishulli në ishull? Mundësia t'ia vesh fajin e tradhtive dhe magjive dhe grave historike? Thirrja e sirenavë? Mundësia për ta dëgjuar deri në fund joshjen, por njëkohësisht të jesh i mbrojtur kundër vetes? Gruaja besnike që e pret, megjithatë, vetëm për t'u plakur me të? Gruaja që refuzon të mirat e kësaj bote për hatrin e një burri të pabesë, vetëm pse është burri i saj? Gruaja që nuk ke nevojë ta fitosh, se ajo të do pa kushte?

A nuk do të duhej me qenë burrëria e Akilit, ajo që nuk i ndahet poezisë së burrave?

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Sa më shumë kalon koha, aq më shumë shndërrohem në liman kujtimesh. E shoh nganjëherë anijen që kalon përbri, në det të hapur. Është prej druri dhe e di se gjethet e kuqe dhe zogjtë ia kujtojnë një jetë prej peme. Dhe e fashis zhurmën e sëpatave në pyll.

**Leximi i poezisë “Vjeshta e hershme dergjet në mua”
të Arben Idrizit**

* * *

*Vjeshta e hershme dergjet në mua,
e vakët dhe e ngeshme.*

E vuaj, mahnitshëm, të qenit.

Njëjtë si pemët, iu bëj hije rrënjëve të mia.

E megjithatë, të gjitha ëndrrat tashmë kanë migruar.

Nuk ishte kështu, nuk mund ta merrja me mend

se do të bënte vaki kështu, as nuk

më shkon mendja të jem i pakënaqur tash.

Jo rrallë njeriu mbetet i shtangur nga e zakonshmja,

e kjo nuk vjen aspak vetëm për shkak të injorancës.

E keqja, e këtë është turp të mos e themi dhe me zë të lartë,

ka qasje autoritare te çdo qenie njerëzore, pa përjashtim.

09 - 11. 09. 2013

Josipa Vancaša, 22

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Kjo poezi më shpërfaqet me dy pamje. Pamja e parë është poezi në kuptimin klasik të fjalës, me mendimin dhe ndjenjën të shprehur figurativisht. Ja, lexoje kështu:

Vjeshta e hershme dergjet në mua,

e vakët dhe e ngeshme.

E vuaj, mahnitshëm, të qenit.

Njëjtë si pemët, iu bëj hije rrënjëve të mia.

E megjithatë, të gjitha ëndrrat tashmë kanë migruar.

Po të ishte një poezi e publikuar në *Facebook*, ma merr mendja do t'i kishim komentuar se këtu mbaron poezia: vjeshta që dergjet në poetin dhe krijon atmosferën e një stine në të cilën pashmangshmërisht gjithçka do të shkundet e kalbet. Vakët dhe ngeshëm. Përzgjedhja e fjalëve dëshmon një talent të veçantë në metafora. Mendoje vetëm këtë: vjeshta dergjet. Dergjet, kjo fjalë e mrekullueshme e shqipes, kjo shtrirje e lëngueshme, që nuk më vjen ndër mend në asnjë gjuhë tjetër. Kjo vjeshtë që dergjet. Dergjet në mua. E shtrirë për të vdekur në poetin. Ngeshëm. Vakët. Sepse është e hershme. Sapo ka filluar. Provoje, lexoje edhe vetëm kështu:

Vjeshta e hershme dergjet në mua,

e vakët dhe e ngeshme.

Edhe këtu, poezia mund të mbaronte si një poezi moderniste. Por ky ngjan se është poet i një lloji tjetër. Tri vargjet që vijojnë e tregojnë përjetimin e dergjjes me shumë zemërgjerësi. Së pari, i

vënë një emër: është vuajtja e të qenit. Dhe vuajtja e të qenit në vetvete nuk është asgjë e jashtëzakonshme për qenien njerëzore. Është një vuajtje e zakonshme, bashkëshoqëruese e ekzistencës së poetit. Poetë të lumtur nuk ka. Ajo që më duket jashtë të zakonshmes është mënyra si vuan ky poet: mahnitshëm. Mendoji vargjet pa këtë fjalë:

E vuaj të qenit.

Njëjtë si pemët, iu bëj hije rrënjëve të mia.

Dhe do të mjaftonte ajo gjetje “u bëj hije rrënjëve të mia” për ta mbajtur vargun gjallë. Por krahasime e metafora të tilla ka shumë. Shqipja është gjuhë e pasur me metafora, prandaj edhe e bekuar me shumë poetë. Me thënë të drejtën, nganjëherë mrekullohem me metaforat dhe gjetjet e poetëve në shqip. Por poezia nuk qëndron te metafora. Qëndron në mënyrën si e përdor atë. Dhe ajo fjalë e thjeshtë “mahnitshëm”, është një levë që e ngre poezinë në një nivel tjetër. Me atë fjalë, e kupton se poezia, në kuptimin klasik të fjalës, nuk ka për t’i mjaftuar poetit. Ajo fjalë, e ngulur aty në mes, tregon se poeti qëndron përmbi gjuhën. Sepse ai vuan mahnitshëm. Mendoje këtë gjetje: pranëvënia e “vuaj”, domethënë diçka që më mundon e më dhemb, me “mahnitshëm”, domethënë habitem shumë nga diçka e jashtëzakonshme.

Nuk ishte kështu, nuk mund ta merrja me mend

se do të bënte vaki kështu, as nuk

më shkon mendja të jem i pakënaqur tash.

Mbasi e ka patinuar poezinë me mjete poetike të përzgjedhura, befas, toni i poezisë ndërron krejt. Si ato vajzat e reja që bëjnë grim dhe zbukurohen, por befas e lajnë gjithçka para se të dalin, sepse grimin e patën veç për qejfin e vet. Vazhdimi i poezisë shtrihet në një nivel të ri.

Jo rrallë njeriu mbetet i shtangur nga e zakonshmja,

e kjo nuk vjen aspak vetëm për shkak të injorancës.

Edhe lexuesi mbet i shtangur këtu. Nga e zakonshmja e fjalëve. Poezia klasike i ka lënë vend përnjëherësh një diskursi të ri. Përshkrimi metaforik i pjesës së parë zëvendësohet me një deklamim të thjeshtë, ku fjalët thonë atë që duan të thonë, drejtpërdrejt. Një lloj morali i përrallës, apo?

E keqja, e këtë është turp të mos e themi dhe me zë të lartë,

ka qasje autoritare te çdo qenie njerëzore, pa përjashtim.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Ti me siguri e ke vënë re se leximi i parë i kësaj poezie nuk ishte leximi i sipërfaqshëm. Ma merr mendja se kjo poezi ka një strukturë projektuese, që pasqyrohet edhe në leximin e saj. Leximi i parë projekton të dytin dhe anasjelltas.

Në poezi, që në njëfarë mënyre është arti i kuptimit të ndërmjetësuar dhe të nënkuptuar, teksti dhe nënteksti vendosen rëndom në struktura vertikale: teksti sipër dhe nënteksti poshtë. Por kjo poezi mbahet në tri struktura paralele:

1. poetika e metaforës;

Vjeshta e hershme dergjet në mua,

e vakët dhe e ngeshme.

E vuaj, mahnitshëm, të qenit.

Njëjtë si pemët, iu bëj hije rrënjëve të mia.

E megjithatë, të gjitha ëndrrat tashmë kanë migruar.

Poezia me P të madhe. Me metafora që zërthehen lehtë që në lexim të parë, si të gjitha metaforat e kësaj bote. Të shoqëruara nga një palëvizshmëri, një gjendje e shtrirë, një pritje e lëngueshme qetësisht. E vetmja lëvizje, migrimi, ka mbaruar. Dhe ka pllakosur dergjja.

2. recitativi lidhës;

Nuk ishte kështu, nuk mund ta merrja me mend

se do të bënte vaki kështu, as nuk

më shkon mendja të jem i pakënaqur tash.

Ky është të vuajturit mahnitshëm. Kjo dergjje ishte diçka e paparashikuar nga poeti, që ka mbetur këtu me rrënjët e veta pa mundur t'i ndjekë ëndrrat që migruan. Por kjo nuk është arsye për të qenë i pakënaqur. Tash. Palëvizshmëria ka pllakosur jo vetëm trupin, pemën që bën hije, por edhe mendjen. Dy shprehje me “mendje” brenda tri vargjeve: “nuk mund ta merrja me mend” dhe “nuk më shkon mendja”. Të dyja folje të lëvizjes “marr” dhe “shkoj” me një NUK të madh përpara. Të vuajturit mahnitshëm. Këto vargje lejojnë vendosjen paralele të strukturës së tretë.

3. poetika e diskursit të drejtpërdrejtë me përgjithësim të qenies njerëzore;

Jo rrallë njeriu mbetet i shtangur nga e zakonshmja,

e kjo nuk vjen aspak vetëm për shkak të injorancës.

E keqja, e këtë është turp të mos e themi dhe me zë të lartë,

ka qasje autoritare te çdo qenie njerëzore, pa përjashtim.

Tashmë gjithçka shpjegohet dhe përgjithësohet. Palëvizshmëria e ka një emër: shtangia nga e zakonshmja. E keqja është autoritare, të lë pa frymë, pa vullnet, pa ëndrra. Të shtang. Jo pse nuk di më mirë, por sepse e keqja e ka këtë qasje te çdo qenie njerëzore, pa përjashtim. Edhe te poeti. Një palëvizshmëri e kushtëzuar, një pemë që u bën hije rrënjëve të veta. Ku ka më të palëvizshme, por njëkohësisht të gjallë se pema?

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Duhet ta pranoj se kjo poezi më ka lidhur kaq shumë me teknikën e përdorur, sa mendimet më sillen e më përsillen jo aq shumë rreth asaj që thotë, por si e thotë. Kjo poezi është ndryshe. Unë jam vetë një nga ato që preferoj poezi që kanë shtresa, mbishtresa dhe nënshtresa. Një poezi pa shtresa është e vdekur. Por ja ku jam e shtangur para një poezie që m'i thotë të gjitha në lexim të parë. Dhe mundohem të kuptoj se pse nuk e kam hedhur tej, siç bëj zakonisht me poezi që flasin shumë, që përpiqen të më japin mend, që ma paraqesin një poet të gjithëdijshtëm, të pikuar nga qielli, më së paku hyjnor? Dhe kam dy përgjigje:

– Së pari, sepse pamja e parë është kaq e bukur, vjeshta që dergjet te poeti, të vuajturit mahnitshëm, pema që i bën hije rrënjëve të veta. Palëvizshmëria, migrimi i ëndrrave, e keqja si një qasje e zakonshme. Poeti si pemë.

– Së dyti, sepse ka një indiferentizëm ndaj lexuesit, që më intrigon. Poeti nuk përgjithëson për të më shtangur mua si lexues, ai thjesht papritmas, në pamjen e dytë, del nga vetja dhe kundron njeriun që shtrihet para këmbëve të veta. Ai vetë, ashtu si e keqja, ka një qasje autoritare ndaj poezisë së vet. Pa përjashtim.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Jo rrallë njeriu mbetet i shtangur nga e zakonshmja.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Tabaku, Entela

Katër lexime për një poezi : doracak /

Entela Tabaku ; red. Arlon Liko.

– Tiranë : Pegi, 2020

128 f. ; 14x21cm.

ISBN 978-9928-310-30-9

1.Letërsia shqipe 2.Poezia 3. Leximi

821.18 -1

028